~~~~~~

FORMIMI DHE VEPRIMTARIA E ORGANIZATËS ILEGALE PATRIOTIKE SHQIPTARE "VUAJTJA" NË PREKAZ TË EPËRM

~~~~~~

Prof. Dr. Sabile Keçmezi-Basha

~~~~~~

Deri sa hulumtoja për monografinë "Një shekull qëndresë të familjes Mehaj" që kryesisht bënë fjalë për atdhetarin e luftëtarin e paepur të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare-Tahir Meha, në Arkivin e Kosovës gjeta edhe dosjen e shumë kërkuar të organizatës ilegale atdhetare "Vuajtja", të formuar më 1958. Në librin "Të burgosurit
~~~~~~

politik shqiptar në Kosovë 1945-1990", kisha hasur në një grup të të dënuarve politik që e përbënin gjashtë veta. Këta emra të nderuar i kisha gjetur në një libër evidencuese që e kishte bërë gjykata e Qarkut në Gjilan, që në vitin 1959. Më shumë të dhëna në atë shënim nuk kishte. Dëshira për të zbuluar më shumë për këtë grup ishte edhe më e madhe kur mësova se anëtar aktiv i këtij grupi kishte qenë Beqir Meha, vëllai më i madh i Tahir Mehës. Por, pasi gjeta dosjen dhe duke e lexuar atë, në mes rreshtave kuptova se anëtar i saj kishte qenë edhe vet Tahir Meha. Në këtë përfundim erdha ngase kur organizata kishte marr qëndrim që për qëllime të organizatës dhe për përgatitjet e ardhshme për luftë të armatosur kundër Serbisë e Jugosllavisë, ata duhet të furnizoheshin edhe me armatim, dhe, mu nga ky qëndrim doli ideja se duhet marrë armatimin e pushtetarëve për nevoja të organizatës.

Me kohë ishte zbuluar se në shkollën fillore të fshatit Prekaz i Epërm ishte sjell një pushkë, ganc e re, por për qëllimin e saj nuk dihej. Anëtarët e organizatës e zbulojnë vendndodhjen e pushkës dhe Beqir Meha e kishte marrë përsipër që ta marri nga aty pushkën e porsaardhur për nevoja te organizatës. Në marrjen e pushkës i kishte ndihmuar edhe vet Tahir Meha. Po të mos ishte anëtar i organizatës ilegale Tahir Meha, shtrohet pyetja athua si do të merrte pjesë në rrëmbimin e saj, kur dihej se në organizatë konspiracioni ishte tepër i thellë dhe qëndrimet e saja ishin tepër të rrepta dhe veprimtarin e saj kryesisht zhvillohej në formë treshesh. Duhet ditur edhe këtë, se rregullat e qëndrimet që merreshin në lëvizjen ilegale kanë qenë shumë precize, te sakta, ngase edhe rreziku për tu zbuluar ka qenë me pasoja fatale për anëtarët e lëvizjes. Andaj, pa qenë anëtarë i organizatës nuk ka pasur mundësi as teorike që dikush të marri pjesë në aksionet qe i ndërmerrnin anëtarët e saja. Më poshtë do të shihet nga vet fotot e udbashve që i kishin inskenuar me vone, se si dukej edhe Tahir Meha në roje duke u kujdesur që vëllai i tij Beqir Meha të përfundonte aksionin me sukses.

Nën një, gjerë më tani askush nuk ka shkrua dhe nuk është zbuluar se Tahir Meha në vitet e 1958-59, ka qenë i organizuar dhe ka marrë pjesë në ndonjë organizatë ilegale. Andaj, nuk duhet befasuar në aktivitetin e më vonshëm të **Bislim Bislimi** Tahir Mehës, ngase me kohë ky ka qenë i informuar dhe aktivisht ka marrë pjesë në rezistencën shqiptare kundër okupatorit.

Nën dy, ka ndodhur shumë shpesh që me rastin e arrestimit e të zbulimit të grupeve ilegale, në asnjë moment nuk është zbuluar i tërë grupi. Ngase, anëtarët e

burgosur në të rrallë kanë treguar për shokët, duke rrezikuar edhe jetën e tyre. Andaj kjo dukuri e mos tregimit të shokëve ka ndodhë edhe me rastin e arrestimeve të grupit "Vuajtja". Me rastin e zbulimit të kësaj organizate, të pazbuluar kanë mbetur një mori personash që kanë qenë anëtar, përkrahës dhe jatak të tyre.

Formimi i organizatës

Sipas dosjes të Sekretariatit të Punëve të Brendshme të lëshuar në hetuesi në Mitrovicë të Kosovës, thuhej se organizatën ilegale "Vuajtja" e kishte formuar Bislim Tahir Bislimi, nga fshati Prekaz i Epërm, bujk. Në tekst thuhej se qysh nga viti 1956, Bislimi ishte përfshi nga ndjenjat patriotike dhe kishte kalua në anën e irredentës, vetëm e vetëm që Kosova mos të jetë e robëruar dhe e ndarë nga shteti amë- Shqipëria. Për qëllime të tilla kishte formuar edhe organizatën ilegale atdhetare "Vuajtja" që në radhët e saja kishte përfshi një numër të konsideruar të personave të pa kënaqur me situatën politike të vendit. Në organizatë merrnin pjesë: Sherif Muslia, Beqir Meha, Ramadan Keqa e të tjerë. Bislim Bislimi, pas shumë bisedave që kishte pasur me ta, kishin ardhur në përfundim se Kosova dhe viset tjera shqiptare ishin të robëruara padrejtësisht nga Serbia dhe Jugosllavia. Pas debateve, mbledhjeve e takimeve të shumta që kishin pasur në përgjithësi me fshatarët, por në veçanti me grupin e njerëzve të pakënaqur me sistemin e pushtetarët jugosllav kishin ardhur në përfundim se diçka duhet bërë... e ajo çka duhet bërë ishte që të organizojnë masat e gjera popullore, t'i mobilizojnë ata dhe të ngritën në kryengritje për ta liruar tokën e robëruar nga armiku shekullor.

Nga takimet e grupit, ishin mbajtur proces verbale dhe kishin marr shumë vendime si: me ra në kontakt me elitën udhëheqëse të Shqipërisë; disa anëtarë të saj me shkua deri në Tiranë dhe atje me iu shpjegua atyre për situatën në Kosovë dhe anasjelltas; për anëtarë që rastësisht do të zbulohen me iu bë të mundshëm largimin jashtë kufirit për Shqipëri. Pastaj në mbledhje të organizatës anëtarëve të caktuar iu dhanë detyrat speciale të cilat duhet kryer (rasti me Beqir Mehën, marrja e pushkës nga shkolla fillore në Prekazin e Epërm); u morë po ashtu qëndrimi që në popull të matet pulsi i qytetarëve lidhur me pakënaqësinë e tyre në shtetin e Jugosllavisë; ose duhet folur me popullin dhe duhet treguar realitetin për padrejtësitë që bëheshin ndaj

shqiptarëve; çdo anëtari iu caktuan detyra, që në radhët e organizatës të anëtarësojnë sa më shumë anëtar të rinj, por kushti thelbësor ishte tradita patriotike në familje dhe angazhimi i tyre i pa kompromis për rrëzimin e pushtetit popullor dhe lufta e madhe për lirimin e tokave shqiptare. Po ashtu, ishte marr qëndrim posa të zbulohet ndonjë anëtarë për veprimtarin e tij me qenë i gatshëm që të kaloi kufirin dhe të vendoset në Shqipëri, por me kushtin qe posa të arrin në tokën e lirë të vazhdojnë po ashtu me veprimtarin patriotike ngase nga atje të veprohet është edhe më lehtë[1].

Bislim Tahir Bislimi përjashtohet nga shkolla pse këndoi këngën "Bini Toskë e bini Gegë"

Në bazë të dokumentit 102/59, kryetari i organizatës ilegale "Vuajtja", Bislim Tahir Bislimi para organeve të hetuesisë kishte deklarua se: "Më vitin 1951 kisha përfundua shkollën tetëvjeçare. Me dëshirën më të madhe për të vazhduar shkollimin, më vitin shkollor 1951/52, shkova në Gjakovë dhe u regjistrova në Shkollën Normale dyvjeçare. Por në kohën e pushimit të parë të atij viti shkollor, më përjashtuan nga aty, për shkakun se me shokë kisha këndua këngën "Bini Toskë e bini Gegë" . Pasi se në Gjakovë nuk munda më tutje me qëndrua, u regjistrova në Mitrovicë po ashtu në shkollën Normale në vitin e parë, mirëpo pas një kohe edhe nga kjo shkollë më larguan, për hir se kishte ndodhur një rrahje e montuar në mes nxënësve. Me përjashtimin e serishëm, mua mu ndërpre edhe perspektiva e shkollimit të mëtejshëm".

Bislim Bislimi ishte kthyer në fshat dhe kishte fillua të merrej me bujqësi. Në vitet në vijim ai ishte angazhua në punët e fushës por nuk kishte pushua së lexuari dhe kuptuari se shqiptarët në shtetin e ri janë qytetar të rendit të dytë dhe nuk gëzojnë kurrfarë të drejtash. Më 1953, punësohej si shitës në një kooperativë bujqësore të fshatit në fshatin Prekaz i Epërm. Me rastin e regjistrimit të kooperativës, i kishte dal mangët 80.000 dinar, por këtë mungesë të të hollave ai kurrë nuk e kishte pranua, por për pushtetarët ishte e rëndësishme që ai përsëri të dënohet. Mu për këtë shkak atij iu shqiptua me 4 muaj burg. Bislimi asnjëherë nuk ishte ndier fajtor, ngase vazhdimisht kishte mendua se e tëra iu kishte montua. Pas daljes nga burgu, Bislimi duke e ditur se ishte montim dhe e ndiente veten të pafajshëm, kishte qenë shumë këmbëngulës në kërkesat e tija për të gjetur punë, mbi 4-5 here kishte shkrua lutje organeve kompetente që ta kthenin në punë, por kjo nuk kishte ndodhur. Pas daljes nga burgu, fizikisht nuk

[1] Deklarat e dhënë me shkrim nga Bislim Tahir Bislimi, para organeve të SPB0së, Mitrovicë e Kosovës, d. 103/59

ishte mirë për të vazhdua me punë të bujqësisë, andaj varfëria e tejskajshme e kishte goditur shumë rëndë atë dhe familjen e tij. Nga e tërë kjo, Bislimi, tani më veç mbi kurrizin e tij kishte ndjerë peshën e rëndë të robërisë dhe kishte filluar me të madhe që të angazhohet në veprimtari ilegale patriotike. Aktiviteti më i madh patriotik i tij vije në shprehje sidomos në vitin 1957, ku edhe haptas me shok kishte shprehur revoltën ndaj sistemit dhe haptas kishte fol për padrejtësitë e shtetit jugosllav ndaj shqiptarëve. Në këtë periudhë, ai edhe venë kontaktet e para me njerëzit që i kishte njohur dhe për të cilët kishte njohuri e besim se edhe ata ishin të pakënaqur dhe ishin të gatshëm që të punonin për Kosovën në veçanti dhe popullin shqiptar në përgjithësi.

Duke e ditur se moshatari i tij, Ali Gjemë Ademi, nga Klina e Ulët, ishte i pakënaqur me situatën politike kishte kërkua që të takoheshin me të. Bislimi e dinte se Alia kishte qenë i kyçur në shumë funksione kushtetore, të rëndësishme në rrethin e Drenicës, por më vonë atë e kishin përjashtua nga Partia Komuniste dhe nga të gjitha postet tjera politike. Në takimin e parë që kishin realizua në vitin 1957, që të dy pajtohen që të ikin për Itali, por nga kjo ide kishin hequr dorë nga arsyeja se nuk do të munden me e realizua ngase Italia ishte larg për të ikur dhe kishin ndërrua mendje se duhet ikur në kushtet më të përshtatshme për Shqipëri por nuk kishin caktua asnjë datë.

Në takimet e shpeshta që kishin pasur me Ademin, dhe duke biseduar dendur e më dendur për situatën e shqiptarëve në Kosovë, për politikën që ndiqte Shqipëria ndaj Jugosllavisë kishin ardhur në përfundim se duhet angazhuar dhe luftuar sa më shumë për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, aty edhe ku e kishte vendin. Se ishte shumë i vështirë qarkullimi në mes dy vendeve si nga Shqipëria për Kosova dhe anasjelltas, kur dihej se muri makabër i ndante këto dy vende të një trungu. Gjatë bisedave të gjata këta dy atdhetar e kishin kuptuar se që të dy ishin nacionalist të thekur të cilët ishin të gatshëm të mos kursenin asgjë që ëndrra e gjeneratave të tëra të bëhej realitet. Ishin të gatshëm që të sakrifikoheshin dhe kishin krijuar aso lidhjesh të besimit reciprok që pa hezituar e frikuar, bisedonin hapur për formimin e një organizate ilegale nacionaliste e cila do të ketë për detyrë që në kushtet e atëhershme të luftoi me çdo mjetë për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Ata, ishin pajtua plotësisht që të formojnë organizatën ilegale dhe të jenë anëtar besnik të saj që të punojnë palodhshëm për qëllimin e saj, brenda të gjitha mundësive që i kishin.

Duhet thënë se Bislimi kishte besim te plotë tek Ademi, se politikisht e dinte se ai ishte i përgatitur mirë dhe në qëndrimet e tij shihte njeriun që idealet e tij kishin taban kombëtar. Me vëmendjen më të madhe përcillte ngjarjet që ndodhnin në arenën kombëtare e ndërkombëtare. Me kujdes përcillte situatën politike në Jugosllavi e Shqipëri; me kureshtjen më të madhe lexonte shtypin e vendit; dëgjonte fshehurazi radio Tiranën dhe me atë rast ishte shumë i përgatitur për të fituar e bindur anëtarësinë e re për organizatë. Me një fjalë Adem Alia ishte një patriot i mirë që kishte ndikim të madh tek të tjerët. Bile, në një rast ai i kishte dhënë për lexim romanin e një shkrimtari jugosllav me një qëllim të vetëm që Bislimi ta pasuronte fjalorin me fjalë politike. Ndërsa në një rast tjetër i kishte huazuar librin me karakter spiunazhi i quajtur "Operacioni Cicero" me qëllim që të kishte njohuri të mjaftueshme me veprimtarin e spiunazhit ndaj organeve të UDB-es, dhe të njihte sa më mirë metodat e tyre. Ai qysh herët kishte filluar që të dëgjonte lajmet nga Radio Tirana, radio Sofija, dhe kur kishte ndodhur që të dëgjonte ndonjë risi për marrëdhëniet në Kosovë e Serbi, e kishte njoftua menjëherë Bislimin në mënyrën sa më të sakët të lajmeve. Ndodhte edhe në vitet e më vonshme, kur kishte ndonjë informacion për shqiptarët në Maqedoni, ai edhe në mes të natës vinte dhe e informonte. Takoheshin shumë shpesh, fshehurazi në shtëpinë e Bislimit apo të Ademit në Klinën e Ulët. Takimet ishin të shpeshta edhe në pazarin e Serbicës. Pas bisedave të gjata me të, Bislimi kthehej në Prekazë dhe të gjitha ia përcillte anëtarëve të organizatës. Shpesh i thoshte se këto që po i tregonta ai, i din edhe anëtarët tjerë të organizatës, pajtohej me të, thoshte "Në rregull, poçes mendon ti se është e nevojshme, vazhdo t'i informosh...".



Adem Alia

Më 27 nëntor 1958, e kishte njoftua Ademin se e kishte formua organizatën nacionaliste 'Vuajtja". I kishte tregua se ai, Bislimi ishte caktuar udhëheqës i saj, por nuk i nuk i kishte tregua se cilët persona janë pranuar në radhët e saja. Jo se nuk kishte

besim tek ai, por vetëm e vetëm për ta ruajtur atë dhe shokët e organizatës. E kishte njoftuar se kohë pas kohe ai takohej me anëtarësinë dhe mbanim mbledhje duke vendosur për gjera të rëndësishme. I kishte treguar se takoheshin edhe në grupe të vogla dy e tre veta. Ai nuk kishte qenë kundër takimeve të tilla, por kishte shpreh frikën dhe kishte shpreh shqetësimin e vet dhe i kishte tërheq vërejtjen se duhet pasur kujdes dhe duhet ruajtur me kujdes, që të mos zbulohen. Ai, Bislimin e kishte porositur se, një formë e punës në ilegalitet me takime të një pas njëshme dhe të fshehta është e përshtatshme dhe është e lidhur ngushtë me konspiracionin. Ai kishte njohuri të shumta për veprimtari ilegale dhe një herë iu kishte tregua se si në një rast, një mjek në kohën e luftës partizane, në prapavijë të frontit kishte mbajtur mbledhje partiake në formë të tresheve, dhe nga kjo doli mesazhi që edhe organizata "Vuajtja" është mirë që të punonte në këtë mënyrë, dhe pa kurrfarë dileme e kishte pranuar dhe gjatë tërë periudhës sa kishte vepruar organizata, kishte aplikuar këtë llojë pune në formë të tresheve.

Ademi, gjatë gjithë kohës sa kishte veprua organizata, kishte qenë i informuar se si punonte ajo dhe çka është qëllimi i saj. Ishte i njoftuar se organizata kishte për qëllim zgjerimin me anëtarë të rinj dhe të besueshëm. Po ashtu për anëtarët e posa pranuar që e kishin për detyrë që ata në objektivin e tyre të kenë pranimin e njerëzve të besueshëm, miqëve dhe pastaj të vazhdohet pranimi i tyre në mënyrë zingjirore. Karakteristik e të pranuarve në radhët e organizatës ishte elementi i pakënaqësisë me sistemin okupues; me gjendjen e mjeruar të shqiptarëve në Kosovë dhe të cilët ishin të gatshëm që të pranojnë çfarëdo detyre dhe ti kryejnë me përgjegjësin më të madhe. Po ashtu organizata kishte marr për detyrë që anëtarët e saj të furnizohen me armatim, dhe në rast se zbulohen të jenë të gatshëm që të kalojnë kufirin për në Shqipëri. Me këtë informatë të marr nga udhëheqësi i organizatës, Ademi kishte shprehur dëshirën që edhe ai kishte dëshirë që të largohej **Sherif Muslia**

nga Kosova për Shqipëri.

Më 29 nëntor 1958, Bislimi kishte shkua në zyrën e tij në Klinën e Ultë dhe nga Ademi kishte kërkua disa fletë letre duke i thënë se më nevojiten për ca shënime nga mbledhjet e organizatës. Me këtë rast ai i kishte dhënë pesë tabak letër dhe një laps për të cilën Bislimi nuk i kishte kërkua. Po ashtu ai organizatën e kishte ndihmua pa pyetur fare se për çfarë kishte nevojë. Në muajin shkurt, 1959, i kishte dhënë 10 tabak letër. Në mënyrë të veçantë Ademi ishte i interesuar që organizata të masivizohej dhe të ketë në radhët e saja sa më shumë njerëz atdhetar e të ditur. Njëherë e kishte informuar Bislimin se një person nga fshati Vitak kishte shpreh dëshirën që të jetë anëtar i organizatës, por lidhja të jetë vet Ademi, personi në fjalë ishte Islam Topallaj. Shpesh kishin biseduar në mes veti se në rast që vjen deri te bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, ai ishte në gjendje që të siguroi një numër të madh të nëpunësve shqiptar që të kalojnë në këtë organizatë. Adem Alia kishte edhe aso informata të sigurta, dhe shpesh i thoshte Bislimit se gjakovaret janë shumë të pakënaqur me situatën dhe se ata kanë filluar që të grumbullohen në Prishtinë dhe të mblidhen rreth Fadil Hoxhës, Xhavit Nimanit, Ismet Shaqirit, Veli Devës të cilët fortë përkrahen në mes veti.

Mbledhjet e organizatës

Në bazë të dokumentacionit, thuhej se njëri ndër anëtarët e parë që është pranua në organizatë ka qenë Ramadan Keça, bujk nga Prekazi i Epërm dhe Sherif Muslia, po ashtu bujk nga i njëjti fshat. Që të dy janë pranuar në organizatë para datës së 29 nëntorit 1958. Që nga pranimi i këtyre dy anëtarëve e deri tek zbulimi i organizatës, në organizatë sipas dokumentit thuhej se janë mbajtur shumë takime e mbledhje të fshehta. Mbledhjet e fshehta janë mbajtur në shtëpinë e Sherif Musliut. Menjëherë pas pranimit të këtyre dy anëtarëve, në nëntor është mbajtur mbledhjen e parë me këta dy. Takimi kryesisht i është kushtua masivizimit të organizatës me anëtar të rinj. Në mbledhje është biseduar që anëtarët e organizatës duhet të kenë kujdes se me kënd po bisedojnë dhe kujt po i propozojnë me u futë në organizatë. Se personat që pranohen në organizatë assesi nuk guxojnë të din se kush është tjetër anëtar dhe nuk duhet ditur se kush është udhëheqës i organizatë, por, atyre t'iu premtohet se ndërkohë do të njihen edhe me të tjerët, dhe më e rëndësishmja ishte që anëtarëve të rinj t'iu përcillen direktivat e udhëheqësit dhe të realizohen në teren.

Beqir Meha

Mbledhja e dytë ishte mbajtur sipas radhës në muajin shkurt 1959, po ashtu në shtëpinë e Sherif Musliut. Kjo mbledhje për rend dite kishte vetëm një pikë të renditë të ditë: përpunimi i Notës së shtetit të FNRJ-së dërguar Shqipërisë, lidhur me depërtimin e spiunëve dhe veprimtarisë së tyre në Kosovë. Lidhur me Notën, që i kishte dërguar Jugosllavia , organizata ishte shumë e disponuar ngase u binden se shteti shqiptarë ishte i interesuar për shqiptarët në Kosovë dhe mu për këtë dërgon njerëz të vetë për një organizimi më të mirë, ndërsa ne, edhe pse jetojmë këtu, jemi shumë pasivë për situatën e krijuar dhe nuk marrim asnjë aktivitet, ishte konstatimi i udhëheqësit. Detyrë e tyre edhe më tej ishte dhe mbeti që edhe ata të organizoheshim që të ndihmonim nga brenda shtetin shqiptarë. Me detyrat që u caktuan në mbledhje, të pranishmit ishin pajtuar një zëri. Në këtë mbledhje ishte mbajtur procesverbali dhe me përpikëri ishte shënuar çdo gjë për secilin veç e veç se çfarë kishte thënë dhe çfarë ishte marr obligim për të bërë.

Në këtë mbledhje Ranmadan Keça kishte shtruar pyetjen se pse, ne, këtu nuk marrim dhe nuk kryejmë ndonjë aksion për likuidimin e disa bashkëpunëtorëve të UDB-es, nga të cilët na kërcënohet rreziku nga zbulimi nga ana e tyre. Udhëheqësi i grupit nuk ishte pajtuar me këtë propozim. Pyetje kishte shtrua edhe anëtari tjetër i organizatës, Sherif Musliu, duke thënë se ne duhet ti ndërpresim lidhjet telefonike dhe ti rrëzojmë banderrat e tyre në vendin e quajtur ”Përroi i keq”. Edhe për këtë aksion u mendua se ishte ende herët që të kalojnë në veprime të tilla. Po ashtu, në mbledhjen e dytë kishte marr pjesë edhe anëtari i tretë i organizatës- Istref Osmani nga Prekazi i Epërm. Procesverbali nga kjo mbledhje u dha në përkujdesje të Sherif Musliut, duke llogaritur se në të, askush nuk dyshonte, ndërsa për procesverbalin anëtarët llogaritnin se ai ishte një dokument i rëndësishëm për organizatën.

Pas mbledhjes së dytë, u konstatua se rezultatet për masivizimin dhe anëtarësimin e anëtarëve të rinj ishte i suksesshëm. Nga ana e Ramadan Keçës u anëtarësuan: Istref Osmani dhe Ibrahim Murseli, që të dy nga Prekazi i Epërm, me profesion ishin bujq dhe kishin një moshë 30-40 vjeçare. Sherif Muslija në mbledhje i kishte informuar të pranishmit se kishte edhe një person që kishte pranua me qenë anëtar i organizatës. Personi ishte nga Kqiqi i Madh, dhe vinte nga një familje atdhetarësh, por për momentin nuk e kishte tregua emrin, por ky person në ndërkohë kishte angazhua një person tjetër (dhe kjo ishte mënyra më e mirë për të mos tregua anëtarët e rinj apo për t'i ruajtur ata pa marrë parasysh se çfarë maltretimesh pësonin. Në hetuesi, thoshin të burgosurit që merreshin në pyetje "shpëto sa të mundesh me shpëtua", kjo ishte ajo që mbronin shokët nga zbulimi i udbashëve.

Në mars të vitit 1959, në organizatë u pranua edhe Beqir Nebih Meha, bujk nga Prekazi i Ulët. Ai që në fillim ishte pajtua me programin dhe qëllimet e organizatës. Që në fillim pa asnjë vërejtje kishte pranua të gjitha detyrat e dhëna nga udhëheqësi i saj. Bile kur ishte në pyetje çështja e masivizimit të organizatës me anëtarë të rinj, ai kishte tregua se në organizatë është i gatshëm me u aktivizua edhe Ajet Fazlia nga Prekazi i Ulët. Ajet Fazlija ishte njëri nga fshatarët që haptas shprehte pakënaqësin me okupimin dhe robërinë e Kosovës. Sidomos e bënte të ndihej keq situata politike që mbretëronte në Kosovë dhe padrejtësitë e shumta që manifestoheshin ndaj shqiptarëve. Në ndërkohë, zhvillimet e paparashikuara ndikuan që Ajeti ngeli i pa përfshirë në organizatë.

Anëtarët e organizatës, gjatë kohës sa veproi organizata "Vuajtja", nuk qëndruan duarkryq. Ata në mënyrë të organizuar kryenin shumë aksione që dëmtonin rëndë veprimet e pushtetarëve. Ata me rrjetin që kishin, e duhet përmendur se kjo ka qenë dukuri e shumë organizatave ilegale, që të evidentonin personat shqiptar që ishin në shërbim të UDB-es. Po ashtu edhe anëtarët e organizatës "Vuajtja" kishin bërë evidentimin e spiunëve shqiptarë, që në

ndërkohë kishte dal edhe propozimi që të fillohet me likuidimin e tyre. Ndodhte shpesh që anëtarët e organizatës të merrnin vendime edhe pa u takuar në ndonjë mbledhje zyrtare. Udhëheqësi i saj kishte të drejt, poçes e shihte të arsyeshme, të jepte detyra aty për aty. Më datë 20-21 mars, 1959, në një takim që kishte pas Beqir Meha me udhëheqësin e organizatës, ai e kishte njoftuar se në shkollën fillore të fshatit Prekaz i Epërm, e kishin sjellur një pushkë, dhe i kishte propozua atij që është mirë që ajo të merret nga shkolla, për nevoja të organizatës. I kishte tregua se më 23 mars, në mbrëmje do të mbahej një mbledhje e organizatës themelore e Partisë Komuniste në zyrën e vendit, në Prekazin e **Ramadan Zeneli** Epërm. I kishte thënë po ashtu se në mbledhje do të marrin pjese edhe korrieri i shkollës dhe vet udhëheqësi i organizatës ilegale, Bislim Bislimi. Me këtë u kuptonte që shkolla dhe lokalet e saja do të jenë pa roje.

Beqir Meha asgjë nuk i kishte premtua udhëheqësit të organizatës, por një ditë më vonë ishte informua se Beqir Meha e kishte krye me sukses aksionin së bashku me vëllamin ma të ri Tahir Mehën, i cili i kishte ndihmuar- duke bërë roje, që marrja e pushkës nga shkolla të jetë e suksesshme. Më vonë, atë pushkë e kishte dorëzua për nevoja të organizatës. Megjithatë, pushka e grabitur nga shkolla kishte mbetur në shtëpinë e Beqir Mehës ngase Bislim Bislimi e kishte parandie se do të zbulohet dhe do të burgoset. Ai mu për këtë kishte mendua që të iki në mal, pastaj nga Beqiri të marri pushkën për nevoja të mbrojtjes nga policia. Me këtë rast Bislimi, Beqirit i kishte dhënë edhe 20 fishek për nevoja të paparashikueshme.

Aksion tjetër që ka kryer kjo organizatë ishte edhe grumbullimi i emrave-bashkëpunëtor të UDB-es. Këtë detyrë e kishte marrë për ta kryer Adem Alia në fshatrat : Tërnavc, Klina e Epërme, e Poshtme dhe e Mesme deri më 31 mars. Ai kishte deklarua se vet i njeh personat-spiun të këtyre fshatrave,dhe nuk ka problem për t'i zbulua.

Deklarata e Musli Sherifit dhënë në organet e hetuesisë

Është interesante që të përmendët se te anëtarët e kësaj organizate që të gjithë

anëtarët e saj para hetuesit e pranojnë se ishin anëtarë të organizatës dhe deklaronin haptas **Istref Hasani** se kanë qenë të pakënaqur me sistemin në Jugosllavi dhe me të gjitha padrejtësitë që iu bënin shqiptarëve aty dhe për veprimet e tyre aspak nuk ndjeheshin fajtor. Ata në hetuesi nuk akuzonin askënd, dhe se nuk kanë qenë të manipuluar apo nuk kanë pasur njohuri se bënin vepër penale. Të gjithë thoshin se: "Ne do të bënim përsëri të njëjtën gjë, po na erdhi për shtegu". Nuk u penduan dhe nuk akuzonin askënd nga shokët e tyre. Nuk zbuluan asnjë anëtarë që nuk ishte zbuluar nga vet organet. Ose ndodhte shpesh, kur të akuzuarit ballafaqoheshin në mes veti, haptas deklaronin se nuk njiheshin në mes veti. Falë qëndrueshmërisë dhe idealit të lartë të tyre, ata rezistonin para torturave e maltretimeve të shumta dhe fal atyre, shumë anëtarë të tjerë mbetën të pa zbuluar.

Musli Sherifi, në deklaratën dhënë para hetuesit Milorad Milivojeviqit, me 15 prill, 1959, në ora 21'30 minuta, në zyrat e hetuesisë, në Seksionin e Punëve të Brendshme në Mitrovicë të Kosovës, kishte deklaruar se "Nuk më kujtohet saktë, por më dukej se në pjesën e dytë të vitit 1958, kishte ardhur ke unë në shtëpi, Bislim Tahir Bislimi nga fshati Prekaz i Epërm. Me këtë rast kemi biseduar gjatë me të lidhur me situatën politike në Kosovë. Bislimi shprehi pakënaqësinë e madhe të daj shtetit të RSFJ-

së, duke përmendur se shqiptarët në këtë shtet janë të diskriminuar dhe nuk kanë

P R E V O D: Zapisnika koje je vodio okrivljeni
Bislimi Tahira Bislim.

23

1

Da bi se formirala jedna ovakva organizacija, kao što smo je mi počeli, potrebno je da smo verni.-

VERA: -Besa.Reč besa kada se kaže, njome se ne daje ništa, ali se ona treba održati, i čuvati kao zenicu oka.Besa je vrhunac čovečjeg karaktera i ona je čovečja hrana, a takodje i porodični obraz.-

NEVERA: -Pabesa.Reč pabesa od svih ostalih reči ona se razlikuje, iz razloga što se ona vidi, a takodje i ona je vrhunac čovečjeg karaktera.Nevera je jedna vrsta mraza koji uništava bilje.Nevera je ustvari korito iz kojeg se hrane psi i divljač.-

JEDAN KRATAK POZIV:Pozvati jedno društvo koje poznaje svoju nacionalnost, koji nepravdu ne trpe i koji odvajaju dobro od lošeg, da svoj život uništi a društvo ne izda.-

17 -XI- 1958 god.

Zapisnik sa održanog sastanka u kući Šerif Muslije, na kojeg su prisustvovali Ramadan Keća, Šerif Muslija i Bislim.Na dnevnom redu, postavljena je diskusija u vezi nepravda u lečilištima na Kosmetu.-

Bislim Tahir: Dragi drugovi jedna nepravda koju mi vidimo ona je u zdravstvenoj službi i njome se rukovodi po svojoj volji.Na primer u K.Mitrovici, ako nisi socijalno osiguran, ne može se naći mesto u bolnici za seljaka.Moja baba prije izvesnog vremena bila je slaba od raka.Javila se u Kos.Mitrovic kada su joj dali uput za Beograd.Pare je potrošila a nije ništa učinjela.U K.Mitrovici, došla je kod Vuksanovića, koji joj je dao upuš za Beograd.Kod njega u stan sa nekoliko jaja i par kokošaka ozdravila je.-

RAZNO:Budući da smo mi još za sada brojno mali, i svaka mera koju bi preduzeli, begstvo i dr. bilo bi beznačajno.Bar ako pobegnemo neka čuje ceo Kosmet.Radi ovog naš broj treba proširiti što više, i prema tome pitao bi Vas dali imate koga koji bi se sa nama složio.U vezi sa tim upitao je Ramadan Keća:Što ćemo mi reći onima koji sa nama trebaju da dodju.Rekao sam mu, da trebamo reći kako smo povezani sa Albanijom i smo

kurrfarë të drejtash. Ne , shqiptaret duhet të bashkohemi me Shqipërinë. Në mes nesh ekziston një kufi, a nuk është absurde në mes shqiptarëve të ketë kufi. Pastaj, ai më propozoi që ne, duhet të ndërmarrim diçka për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Unë isha i entuziazmuar dhe me të gjitha që thoshte ai, pajtohesha se bashkimi kombëtar ishte dëshir e kamotshme e popullit tonë. Në nëntor, Bislimi më kishte njoftuar se ekziston një organizatë e cila lufton për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe që shqiptaret njëherë e përgjithmonë të jenë të lirë në tokën e tyre. Edhe me këtë u pajtova dhe pranova që të jem anëtar i kësaj organizate. Po ashtu, pranova që t'i marri dhe ti krye me nder të gjitha detyrat që mi caktonte ajo.

Në mbledhjet e organizatës, rregullisht ishte mbajtur procesverbali dhe ishte fshehur e ruajtur me kujdesin më të madh. Sherif Musliu, gjatë kohës sa kishte veprua në organizatë, i kishte njoftuar anëtarët për mbledhjet që do të mbahen. Detyrë e të gjithë anëtarëve kishte qenë që sa më shumë të propagandojnë tek njerëzit e besueshëm lidhur me anëtarësimin në organizatë. Kishte qenë vetë Sherifi që në një mbledhje kishte propozua që të ndërmarrin aksione sa më konkrete si: rrëzimin e banderrave për të ndërprerë rrymën elektrike dhe lidhjet telefonike, rrënimin e urave që policia e Jugosllavisë mos të mundet me krye aksione nëpër fshatra të Drenicës.

Në muajin shkurt, 1959, ishte mbajtur një mbledhje në shtëpinë e Sherifit, në të cilën kishin marr pjesë treshja e parë e organizatës si: Bislim Bislimi, Ramadan Keqa dhe Sherif Muslia. Në këtë mbledhje ishte përpunua Nota e Jugosllavisë e cila iu kishte dërgua shtetit shqiptar për grupet diversantë që po i hidhte në Jugosllavi. Në këtë mbledhje kishin ardhur në përfundim se Shqipëria me të madhe kishte filluar me u marrë me çështjen e Kosovës, ngase po angazhonte njerëzit e shkolluar e të ditur për të kalua në Kosovë, dhe për të zbuluar njerëzit e pakënaqur dhe ata persona që donin të punonin për bashkimin e tokave shqiptare. Po ashtu, në mbledhje ishte prezantua edhe shkresa prej tri faqeve që e kishte shkruar vet Bislimi, e cila në tërësi përputhej me detyrat e anëtarëve të spiunazhit shqiptar të cilët para ca muajve ishin dënuar nga gjykatat e Jugosllavisë. Në mbledhje ishte konstatua se qëllimet e organizatës ilegale dhe të Shqipërisë ishin të njëjta, çlirimi i Kosovës dhe bashkimi i saj me të. Të gjitha vërejtjet dhe propozimet nga ana e anëtarëve ishin të shënuara me besnikërinë më të madhe në procesverbal, por edhe letra të cilën e kishte shkrua Bislimi iu dhanë në ruajtje Sherif Musliut, ngase ekzistonte frika se duke shkuar në shtëpi, do të arrestoheshin dhe të zbuloheshin të gjitha dokumentet e organizatës.

Proqesverbalet e organizatës, por edhe ato të mëhershmet i kishte marr në ruajtje Sherifi, ku më rastin e zbulimit të tyre kishte deklarua se ato i kishte fshehur në arkën, ku gruaja e tij kishte futur çejzin e nusërisë. Por kur merret vesh se ishte zbuluar veprimtaria e organizatës, Sherifi me 14 prill të vitit 1959, para se të lindte dielli i kishte djegur duke i hedhur në oxhakun e shtëpisë që të gjitha. Ai ishte frikua se hetuesit do i zbulonin materialet dhe do të zbulohen shumë persona.

Hetuesia e Sherif Muslijes kishte përfundua në ora 22'30 minuta.[2]

Marrja në pyetje e anëtarëve të organizatës ilegale "Vuajtja"

Të arrestuarit, anëtarët e organizatave ilegale atdhetare në Kosovë, zakonisht nuk merreshin vetëm një herë në pyetje. Anëtarët e arrestuar me ditë të tëra torturoheshin e pastaj ishin të pyetur mos rastësisht kanë harruar diçka për të treguar. Kur ata vinin buzë vdekjes nga rrahjet e vazhdueshme ishte krejt e natyrshme që të dilte ndoshta edhe ndonjë fjalë që nuk e kishte vendin që të thuhej. Por e vërteta është kjo se, maltretimet ndaj të burgosurve politik, veçantë ndaj atyre që tregoheshin më të qëndrueshëm, torturat ishin shtazarake.

Në një deklaratë të Sherif Muslis, tregohet në detaje se si punohej me njerëzit kur donin që ti anëtarësonin në organizatë. Vëmendja e personit kryesisht përqendrohej në qëndrueshmërinë e personit, në besnikërinë e tij ndaj fjalës së dhënë, dhe parimisht anëtarësonin personat që kishin lidhje familjare (miqtë, shokët dhe familjaret, rrethi më i gjerë). Fillimisht fillonin me takime të zakonshme, pastaj ato shpeshtoheshin, diskutonin lidhur me probleme familjare, pastaj kalonin në biseda pak më të zgjeruara dhe krejt në fund matej pulsi për pakënaqësinë apo kënaqësinë ndaj sistemit dhe situatës politike në vend, me theks të veçantë në Kosovë. Kjo ishte edhe parimi kryesor që çdo anëtar i përmbahej kësaj.

Sherif Muslija kishte dashur ta anëtarësonte kunatin e motrës së tij. Duke e ditur se familja e dhëndrit ishte një familje me tradita patriotike, ai kishte vendosur që të bisedonte shtruar me Sadri Sali Shoshollin nga fshati Kqiq i Madh. Me sa i kujtohet Sherifit, se, me të kishte pasur tri takime. Takimin e parë e kishte zhvillua gjatë kohës së ramazanit. Kryesisht bisedat ishin zhvilluar të shtunave ngase të premteve ai kishte shkua me e vizitua motrën Rabë në Kqiqin e Madh, e të shtunën bashkë me Sadrijen

[2] Deklarat e Sherif Muslisë, K.U. 102/59, Mitrovicë e Kosovës

kishin shkua në pazarin e Mitrovicës. Dhe, zakonisht duke shkuar rrugës, Sherifi e

K.U. 102/59.

1

Për men formue nji shoqni e ketillë si që kemi fillue këte t'onën, si përpara duhët me qenë „Besa" fjala e vertetë:

Besa: Fjala besa kur flitët nukë të premtonë asgja, por besa duhët që të mbahët dhe të ruhët njisoj si dritat e synit. Besa âsht thelbi i karakterit të çdo njeriu, „besa âsht uslgimi i njerzis" „besa âsht gardhja e trimnis" besa âsht dhe fytyra e bardhë e shtëpis etjera.

Pabesa: Fjala pabesa prej të gjitha fjalve tjera dallohet se kjo fjalë âshtë e dukshme, para bohët e pabesa e mbasandaj folët, edhe pabesa âsht thelbi i karakterit të njeriut. „Pabesa âsht mbrazi që i thanë rranjët trimnis" Pabesa âsht korito ku ushqehën qytë dhe bisha tjera e tjera...

Nji thirje e shkurtën: thras nji shoqni që e njehë kombin e vetë, që padrejtësin e urrenë në çdo vend, që e ndanë të mirën nga e keqja që ta njehë ushullen dhe mjaltën që vehtën e pretë e shoqnin se shetë. etj.

17-IX-1958 vit.

Proqes i mbajtun në takimin në oden e Sherif Muslis Prekoz. Morrin pjesë Ramadan Hoxha dhe Sherif Muslija. rendi i ditës ka qen padrejtësit në mjekime- mban Bislim Coliri.

Të dashtun shokë neve shohim në çdo vend dhe hasim në padrejtësi por nji që na bjenë ma qesh në sy âshtë mjekimi nëpër spitale të ndryshme. Aparati mjekus-(sterus) udhëheqë si mbas qyfit të vetë, p.sh. në Mitrovicë në qoftë së nuk je nën siguranjë âshtë e kotë me pas vendë shprozët për katundar ose në qoftë se nuk nji fish me mjekun në stan. Që përshembull disa:

Baba i jem Coliri para nji kohe e pati nanën e vetë smut, prej raku në buzë, u paraqitë të mjeku në Mitrovicë, i dhan nji -uput- për Beograd shkojti në Beograd, ju sosen (harxhuen) të hollat, dhe u-kthye me gjith nanë të pa sherueme, erdhi në Mitrovicë prapë te Dr. Vuksanoviqi kue kishte marr -yputin- dhe në stan me të holla dhe disa copa pula e vezë e morri dhe mbrenda nji kohe të shkurtë e shendoshi, e kemi edhe shum tjerë

kishte pyetur Sadrijen se a e di se çfarë është Besa, dhe çka është jo besa. Ai ishte përgjigjur se besnik është ai person i cili flet dhe e mban fjalën e dhënë, dhe jo besa është ajo kur njeriu të jep fjalën, por nuk e mban atë, nuk i përmbush premtimet e dhëna.

Pas këtij takimi, ai ishte takua përsëri me Sadrien. Në këtë takimi i kishte tregua se ishte anëtar i një organizate ilegale, e cila ka për qëllim që të angazhohej dhe të luftojë për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. "Kisha bisedua me të se është mirë që edhe ai të angazhohej dhe të bind njerëzit që të anëtarësohen në këtë organizatë, por fillimisht ata persona duhet të jenë të besueshëm" kishte thënë Sherifi. Por, kur e kishte pyetur më vonë për këtë ai i kishte thënë se nuk kishte njohuri të mjaftueshme për organizatën. Në takimin e tretë, kur e kishte pyetur se çfarë mendon, ai i kishte thënë se çfarëdo i propozon ai, ai është i gatshëm të punoi dhe të veproi. Po ashtu në ndërkohë kishte bisedua me një shokë i cili ishte i gatshëm që të anëtarësohej në organizatë, por emrin e atij personi nuk ia kishte tregua[3].

Në organizatë ishte bisedua, një javë para se të zbulohej ajo, se nga shkolla fillore e Prekazit të Epërm ishte grabitur një pushkë për nevoja të organizatës. Kështu do të vazhdohet edhe në të ardhmen, në grumbullimin e armatimit dhe me këto do të bëjmë rrënimin e sistemit politik në Kosovë dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Në këtë mbledhje kishte marr pjesë edhe Istref Osmani nga Prekazi i Epërm. Po në këtë mbledhje ishin njoftuar se edhe Istrefi ishte anëtar i organizatës.

[3]Deklaratë e dhënë në lokalet e SPB, Mitrovicë e Kosovës, 8 maj 1959, ora 9 e mëngjesit. E përfunduar në ora 10.

Të akuzuarin në pyetje e kishte marr hetuesi Gjoko Mijanoviq, ndërsa procesverbalin e kishte mbajtur Milorad Milojeviqi. Sipas të dhënave që ekzistojnë në dosjen e kësaj organizate, duket qart se të gjithë hetuesit që i merrnin në pyetje të akuzuarit zakonisht ishin serb, procesmbajtësit ishin serbë dhe personi zyrtar ishte serb. Dhe, çka mund të pritet nga një gjykatës serb dhe me prokuror serb, kur nga këto procese gjyqësore shqiptoheshin dënime me vite të larta burgu.

Deklarata e Beqir Nebih Mejës

Beqir Nebi Meha i lindur me 1936, në Prekazin e Ulët, nga babai Nebi e nëna Hanife, e lindur Vojvoda. Shqiptarë. Me profesion bujk. I martuar, analfabet. Gjendja ekonomike, i varfër. I pa dënuar, i pa dekoruar dhe i pa ndëshkuar ndonjëherë nga ana e organeve shtetërore. Letërnjoftimin e ka të marr me datë 26.09.1952 në Serbicë.

Beqir Meha me dëshirën e tij, pa presion e kërcënim ishte anëtarësuar në organizatën ilegale atdhetare "Vuajtja" në Prekazin e Epërm. Beqiri, fillimisht nuk

kishte pasur njohuri se në Prekazin e Epërm ishte formua organizata, por gjatë tërë kohës pas Luftës së Dytë Botërore, ai haptas kishte shprehur pakënaqësinë e tij që Kosova pa dashjen e saj kishte ngelur e okupuar nga Serbia e Jugosllavia. Gjenerata e gjenerata të familjes Mehaj kishin luftuar për një Shqipëri etnike e të plotë. Andaj, atdhetaret kudo që ishin dhe punonin për çështjen kombëtare i dinin dhe i përcillnin ngjarjet dhe njerëzit që punonin për të njëjtën kauzë.

Bislim Bislimi, udhëheqës i organizatës, e dinte se Beqir Meha ishte një burrë trim dhe atdhetar i devotshëm. E dinte se gjysh e stërgjysh kishin luftua për Shqipërinë dhe mbrojtjen e tokave shqiptare por, me padurim priste që të vije momenti për ta informua për ekzistimin dhe për formimin e organizatës ilegale.

Beqir Meha në deklaratën e tij thotë se nuk i kujtohet saktë dita, por diku në muajin janar e kishte thirr Bislimi ne shtëpi se kishte diçka me bisedua. I kujtohej edhe kjo se dita ishte e hënë dhe ishte ditë tregu në Serbicë, "Kur u takova me të, pran hotelit, nën transformator, pas shumë bisedave Bislimi e kishte pyetur se a dëshiron të jetë anëtar i një organizate ilegale ku e udhëheqë vet ai". Çka ishte e vërteta ai nuk e dinte se çfarë organizate ishte ajo dhe nga ai kërkoi që shkurtimisht ta informonte se çfarë programi ka dhe kush janë anëtarët e saj, qëllimet dhe objektivat e saja. Bislimi pas një prezantimi të shkurtër të organizatës që i kishte tregua se organizatën e kishin pagëzua me emrin "Vuajtja", që do të thotë, populli shqiptarë nën pushtetin jugosllav nuk ka përjetua tjetër gjë përveç vuajtjeve të vazhdueshme. Andaj, i kishte thënë se qëllimi i saj është lufta e vazhdueshme që Kosova të bashkohet me Shqipërinë. Po ashtu duhet luftua që të rrënojnë këtë vëllazërim e bashkim të shpifur, që në të vërtet është fals dhe nuk ka kurrfarë të drejtash për popullin shqiptarë.

Beqir Meha kur kishte kuptua se organizata po angazhohej për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, pa hezituar kishte pranua që të jetë anëtar i saj. Po aty dhe po atë ditë kishte marrë edhe detyrat e para nga organizata. Ai i kishte thënë vetes se duhej në mënyrë të vazhdueshme të angazhohej për masivizimin e saj në rajonin e Drenicës dhe në mënyrë konsekuent të përcjellin të gjitha direktivat që merreshin nga udhëheqësi i saj. Të përhapshin të vërtetën në popull se si shqiptarët në Jugosllavi nuk kanë kurrfarë të drejtash dhe janë të shtypur si pakicë nacionale, do të shembnin urat që të kuptoj pushteti që populli shqiptar është i pakënaqur dhe se ekziston dikush që po punon dhe po lufton për të drejtat e tij. Njëra ndër detyrat primare ishte grumbullimi i armatimit për nevoja të organizatës, të grabiten ato kudo që ka mundësi në sektorin

shtetëror por edhe brenda mundësive edhe të blihen me parat e anëtarëve të saj. Me



НР СРБИЈА АКМ ОБЛАСТ - RP E SERBIS KRAHINA AKM
НАРОДНИ ОДБОР СРЕЗА КОС. МИТРОВИЦА
KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT K. MITROVICE
СЕКРЕТАРИЈАТ ЗА УНУТРАШЊЕ ПОСЛОВЕ
SEKRETARJATI PER PUNE TE MBRENDESHME

K. v. 102/59
K dh.

14

БРОЈ 251
Nr.
14-IV- 1959 г.
v.
КОС. МИТРОВИЦА - KOS. MITROVICA

Овлашћени орган унутрашњих послова Секретаријата за унутрашње послове НО среза Косовска Митровица у Organi autorizuem i puneve të mbrendshëme të Sekretarijatit për punët e mbrendshëme të KP rrethit të Mitrovices se Kos. në

Кос. Митровици, по кривичној ствари окривљеног BISLIMI TAHIRA BISLIM
Mitrovicë, për punën fajtore t'akuzuemit

из Gornjeg Prekaza због кривичног дела ... из чл. 117 Кривичног законика,
nga për veprim fajtuer nga neni të ligjit penal,

донео је на основу члана 182 став 2 тач. 2 и чл. 183 Законика о кривичном поступку, на дан 14-IV- 1959 г. следеће:
në bazë të nenit 182, paragraf 2 pikes dhe nenit 183 të ligjit mbi procedurën fajtore, me ot ka pru këtë

РЕШЕЊЕ - VENDIM

Одређује се притвор против BISLIMI TAHIRA BISLIMA из Gornjeg Prekaza
Caktohet paraburgimi ndoj nga

по занимању zemljoradnik окривљеног због кривичног дела ... из чл. 117, st,1
me profesion t'akuzuemit për veprim fajtuer nga neni

Крив законика пошто постоје основи из чл. 182 ст 2 тач. 2 Законика о кривичном поступку који су потребни за
të ligjit penal mbasi eksistojnë bazat nga neni 182 paragrafi 2 pik në Ligjin mbi procedurën fajtore të cilat janë të nevojshme për

примену ове мере, — с тим што ће се исти (притвор) рачунати од /Četrnajestog aprila hiljadu devet
zbatimin e këtine masave ashtu që ky paraburgimi të logaritet prej

sto pedeset devete godine u 20 časova/

(дан, месец, година и час биће исписани и цифрама и словима) као момента лишења слободе.
(dita, muj, viti dhe ora do të shënohet me shifra dhe germa) si moment marrja së liris.

Окривљени BISLIMI TAHITA BISLIM има право жалбе на ово
I akuzuemi ka të drejtë ankese kundra

решење преко овог органа Већу Окружног суда у року од 24 часа притварања или приликом првог испитивања у извиђају.
këtij vendimi përkrye këtij organi në Kuvendim e gjygjit të Qarkut n'afatin e 24 orëve të paraburgimit ose me rastin e marrjes së parë në pyetje

ОБРАЗЛОЖЕЊЕ: — ARSYETIM:

Okrivljeni se počet od 1956 godine ideološki opredelio na strani iridente.Kao takad u korist iste vrbovao je jedab broj lica, kao što je slučaj sa Šerif Muslijom,Bećir Nebijom,Ramadan Kećom i dr. Održavao je sa istima povremene sastanke, diskutovali o stanju na Kosmetu i politici koju Albanija vodi prema našoj zemlji.Od ovih lica formira je nacionalističku organizaciju, zvanu "Vujtetë.Pripremali se za begstvo u Albaniji i sl.Postavljao je zadatke pojedinim članovima, kao što je slučaj sa Bećir Nebijom po čijem direktivom je ukrao pušku u korist organizacije, širio nezadovoljstvo i postavljao da se radi na pridobijanju novih članova, koji bi se borili protiv društvenog uredjenja u FNRJ i bili spremni pobeći za Albaniju.-

Jedna ovakva mera je neophodna, tim prije što bi svojim boravkom na slobodi, osujetio pravilan tok izvidjajnih radnji, a takodje mogao bi i pobeći, pa je radi toga rešeno kao u dispozitivu samog rešenja.-

Смрт фашизму - Слобода народу! — Vdekje fashizmit - Liri popullit!

Признајем да ми је данас /četrnajestogaprilahiljadu-
Pranoj që sot mi asht
devetstopedesetidevetegodineudvadeset-
časova/

(печат)

Овлашћени орган унутр. послова
Organi autorizues i punës të mbrendsheme
/Milanović Djoko/

Потпис окривљеног — Nënshkrimi i t'akuzuemit
/Bislim Tahita Bislim/

marrjen e detyrave e obligimeve, Beqiri thotë se “e mora shumë seriozisht dhe në të ardhmen

Në foto duken Beqir Meha (tek dritarja e shkollës) dhe Tahir Meha (duke bërë roje tek qoshi i shkollës fillore, në Prekazin e Epërm).

kam qenë anëtar i devotshëm i saj duke mos kursye as jetën për të”.

Takimet e Beqirit me Bislimin në të ardhmen kishin qenë të vazhdueshme. Takoheshin shpesh dhe bisedonin shtruar për situatën politike e gjendjen ekonomike në Kosovë. Takimet (mbledhjet) siç i quan Beqiri, mbaheshin edhe me dy vet, ngase ishte më praktike se qëndrimet pastaj përcilleshin tek të tjerët e kështu me radhë. Ndodhte që takimet mbaheshin në rrugë, në ara, në treg, në ndeja të zakonshme ,e më së shpeshti mbaheshin në familje. Shpesh ndodhte kur njëri anëtar i thërriste disa shokë në drekë apo darkë tek tjetri dhe kështu zhvilloheshin edhe biseda e debate të shumta lidhur me veprimtarin dhe detyrat e organizatës.

Bislim Bislimi, si udhëheqës që ishte, në fund të marsit, ishte ditë e hënë, e kishte thirrur në një drekë në shtëpinë e tij. Në familjen e tij ishin që të gjithë familjarët, andaj biseda rreth organizatës ishte e pamundur. Kur isha nisur për të dal, ai e kishte përcjell gjatë mysafirin, por duke kaluar pran shkollës së Prekazit të Epërm, Bislimi i kishte

tregua se po atë natë ata kishin një mbledhje të Partisë Komuniste, dhe në atë mbledhje do të jenë të gjithë, kështu që në shkollë nuk do të jetë askush, dhe tërthorazi i kishte propozuar që ishte mirë që sonte nga shkolla të grabitet pushka për nevoja të organizatës. "Pas kësaj bisede" kishte thënë Beqiri se vazhdimisht kishte mendua se si do ta realizonte këtë planë. Në shtëpi, kishte bisedua me vëllanë më të vogël- Tahirin dhe tek ai kishte gjet përkrahje të plotë. Nga ai kërkova që të më ndihmojë lidhur me grabitjen. Tahir Meha edhe pse asnjëherë nuk ishte dëshmua se ishte anëtar i organizatë, por vetvetiu kuptohej ngase ata që nuk ishin anëtarë nuk kishin as njohuri lidhur me veprimtarin dhe detyrat e saja. Tahir Meha bashkë me vëllanë kishte marrë pjesë në grabitje duke bërë roje dhe duke u kujdesur që mos të ndodhë ndonjë e papritur.

Nga dhoma e fjetjes së drejtorit, Beqir Meha kishte marr pushkën, 30 fishek dhe një çarçaf që e kishte marr nga dhoma vetëm për të mbështjell pushkën që më lehtë për ta bartur deri në shtëpi. Lajmi ishte përhapur shumë shpejt se dikush e kishte grabitur pushkën nga lokalet e shkollës. Bislimi e kishte marr me mend se këtë detyrë e kishte krye vet Beqiri, dhe pas tri dite ishin takuar me të. Ai kishte kërkua nga Beqiri që ta dorëzonte pushkën në organizatë, ngase ajo ishte marr për nevoja të organizatës. Fillimisht ai nuk kishte pranua, por më vonë ishte bindur dhe në ndërkohë me pushkë në dorë kishte shkua tek Bislimi për ta dorëzuar pushkën. Pasi se e kishin sheshua mirë e mirë problemin, vendoset që pushka edhe më tej të qëndroj në shtëpinë e Beqirit dhe për çdo rast që ka nevojë organizata ajo do të dorëzohet. Anëtarët e organizatës që të gjithë e dinin se pushka ishte marr nga shkolla dhe ishte në vend të sigurt. Dhe duhet përmendur këtë, se, ka qenë rregull e vendim i pashkruar që anëtarët e organizatës të cilët tregojnë e tradhtojnë organizatën, ndaj tyre do të merren masa të menjëhershme me likuidim.[4] Në organizatë ishte marr edhe ky vendim se poçes ndodhë që të zbulohet organizata, të gjithë anëtarët do të ikim në Shqipëri. Të gjithë anëtarët e organizatës njëzëri e kishin miratua këtë propozim duke e ngritur në obligim të anëtarëve.

[4] Deklarat e Beqir Mehës dhënë në lokalet e SPB-së në Mitrovicë të Kosovës, më 15 prill 1959, K.u 102/59

Ka qenë rregull i pa shkruar se, edhe në organet e hetuesisë në Jugosllavi, zakonisht të burgosurit në burgun hetues merreshin në pyetje në orët e vona të mbrëmjes ose në orët e hershme të mëngjesit. Hetuesit llogaritnin që në ato orë të ima të natës apo të mëngjesit të burgosurit janë të lodhur, të përgjumur dhe të papërgatitur për t'i



Beqir Meha pasi e kishte marrë pushkën.

rezistuar torturave. Këtë dukuri të hetuesisë, organet kompetente të SPB-së, e kishin manifestua edhe ndaj anëtarëve të kësaj organizate. Ta zëmë, Beqir Mehën e kishin marr në pyetje pa paralajmërim në orën 20, dhe hetuesia kishte zgjatë deri në ora 21, kuptohej se gjatë marrjes në hetuesi, ishte e lejueshme çdo lloj torture, ama pa pranin e ndonjë dëshmitari. Shpesh ka ndodhur që personat që merreshin në hetuesi, nga atje në qelit e tyre silleshin pa vetëdije, të gjakosur, me dhëmbë e gjymtyrë të thyera e çka jo tjetër.

Hetuesit apo personi zyrtar që i merrte në pyetje të burgosurit, zakonisht nuk ishin të njëjtë. Kështu ekzistonte frika që ata do të zbulohen se kush janë dhe frika ekzistonte nga ndonjë hakmarrje. Në të shumtën e rasteve hetuesit ishin serbë, dhe që nuk kishin fare ndjeshmëri ndaj personave që merrnin në pyetje.

Deklarata e Ali Gjemë Ademit

Të dashtun shokë neve shohim në çdo vend dhe hasim në padrejtësi por nji që na bjenë ma shpesh në sy asht mjekimi neper spitale të ndryshme . Aparati mjekues (sherues) udhëheqë si pas qejfit të vetë, psh. Në Mitrovicë në qoftë se nuk je nën

siguranjë asht e kotë me pas vendë shprazt për katundar ose në qoftë se nuk njihesh me mjekun në stan. Që përshembull disa: Baba i jem Tahiri para nji kohe e pati nanen e vet smut, prej- raku në buxë. U paraqit te mjeku në Mitrovicë, i dhanë nji put për Beograd, shkojti në në Beograd, ju sosen (hargjuan) të hollat, dhe u kthye me gjithë nanen të pa serume, erdhi në Mitrovicë prap te Dr. Vuksanoviqi ku e kishte marr putin dhe në stan me të holla dhe disa copa pula e veze, e morri dhe brenda nji kohe të shkurtë e shëndoshi, e kemi edhe shumë tjera.

Eventuale: Tash meqenëse neve jemi shumë pak dhe çdo punë ose çdo ikje kishte me qenë shumë pavleftë, bare në qoftë se ikim dotë ndien mbar Kosmeti. Për këtë arsye duhet që këtë numër me zgjanue sa ma shumë, dhe kishem meu vetë juve a kini ndonji shok që do të pëlqej me juve apo jo. Ramadan Keqa pyet si dotu thomi na atyne që me ardhë me neve. (Bisa) neve do tu thom që kemi lidhje me Shqipni, dhe do të jemi edhe nën rrogë. Ky propozim u pranue nga ana e tyne. Ramadani: une për afër 10 vetë mundem me i organizue, e nja dy i kam veq te gatem ata janë Brahim Murseli dhe Istref Osmani. Sherifi thotë une due me shkue, e kam nja dikun e ku sa nevoja me ditë ju.

Të dashtun shok edhe une e kam nji shum i kthjellt dhe në qendër ku mundim çdo lajm dhe punë politike me marr vesh dhe simbas mendimit tem asht shumë i zellshem dhe trim shqiptar.

Ramadani- Ju lutem mos po na shplonë se duket si shumë punon për pushtet (Unë e garantova që jo)

Në takimin e ardhshem do të takohemi edhe me ata shokët e juaj shok Ramadan e Sherif- e pranojmi.

Mbledhja e tretë

....1958...

Klinë e Epërm

Takimi me Adem Aliun arkëtar i Koop. Bujqësore.

Pa proqes: Mbrenda ne zyre ka qenë Ibish Zena dhe me thotë që ta pres deri të maron puna, i dhash nj letër mema shtypë në maqin- më tha ma jep për natje netra e ta qoj për atë vllahun që e kije në gjimnaz në Serbicë mbasi ai gjithë kthehet kah na me lue me thmi tonë- unë spranova, veq i thash mema dhanë do letra me punue edhe une diçka, ku me dha nji tabak edhe nji laps e nji liber- Shkrimtaret jugosllav- Puna e zyres mbaroi dhe jemi dal në rrugë për Mitrovicë tue hecë ngadalë dhe tue bisedue, ku une e njoftova Ademin me takimin që në ardhshem kemi me mbajt, Ademi më qortoi me këto fjalë: Unë e di që ti je budall bre Bislim se nuk mbahet takimi me nji shumicë shokësh, se ata

mund bahet që e shplojn shoqi shoqin me ndnji inati. Por duhet me mbajt me praktikën e aradheve partizane. Psh. Nji doktorr ka mbajt takim 60-100 shokë edhe veq në treshe e prandaj edhe ti ashtu duhet.

Daja Adem une po e pranoi kete por qellimin kryesor e kam me tejkalue kufirin, po e shof se fizikisht jamë shumë i dobt me punue mbasi çdo ditë mari injeksione, por shpetimi i jem ashtë me kalue kufinin e ose me vazhdue shkollën ose me marr rrogen e me ndejt e ndoshta barem shëndoshna.

Ademi: Pash nderin kur vjen puna me kalue më lajmron edhe mue se rroga 7000 din. Me shoqni spo del me pi. Unë i thash: në qoftëse punon eja edhe ti me neve. Ademi tha në qoft nevoja edhe me çdo takim vi, por e mira asht që ju të mbani, me mue mos të takoheni se kamë shumë hetime nga UDB-a.

I kam dhanë si detyrë mbasi punon ketu që t[i shplojë spiunet në këto katune Klinë e Ulët, Klinë e Mesme, Klinë e Epërme dhe Tërnavc, premtimin ma dha që brenda nji kohe të shkurt ka me krye ketë detyrë.

Muer fund bisedimi i ynë te Tahirovit e Klinës.

Mbledhja e katërt

27 Nanduer 1958 viti,

Prekazi i Epër.

Proqesi i mbajtun në takimin e treshës sonë Ramadani, Sherifi edhe Bislimi. Rendi i ditës: Festa nacionale e 28 Nandori 1912 edhe eventuale. Në odën e Sherif Muslis.

Të dashtun shokë në këto ditë mbahet festimi në mbar Shqipnin, ku valojn flamujt e ndryshëm të Shqipënisë e nuk ka as kand e ndertes që nuk ngrihet flamuri kombtar dhe kang e valle shqipe.

Ramadani pyet: A doni me nderrmar farë detyre me krye në këto ditë për nderë të festës kombëtare?

Ju lutem shok Ramadan vetëm e vetëm ky takim i ynë do të jet si kujtim i kësaj date të lavdishme.

Sherifi pyet dotëishte lehtë fare që në prure të keq edhe meu kput telat e telefonit asht shumë vend i përshtatshëm për ndonji aksion...

I dashtuni shok Sherif kjo dotë ishte krye po në qoft se neve e parashohim me hik, e kjo



128

cl.46 Kz sud mu za oba ova krivicna dela odmerava jednu ukupnu po=
visenu kaznu strogog zatvora u trajanju od 2/dve/godine,koja ce mu
se kazna racunati od 15 aprila 1959 godine,tj.dana kada je slobode
lisen.

5.Optuzenog Ramadana Zenela,na kaznu strogog zatvora u tra=
janju od 2/dve/godine,koja ce mu se kazna racunati od 20 aprila 1959
godine,tj.dana kada je slobode lisen,i

6.Optuzenog Istref Hasani,na kaznu strogog zatvora u tra=
janju od 1/jedne/godine i 6/sest/meseci,koja ce mu se kazna racuna=
ti od 20 aprila 1959 godine,tj.dana kada je slobode lisen.

Svi optuzeni se osudjuju da plate po 500.-dinara na ime pa=
usala,a ostale troskove krivicnog postupka solidarno koliko isti po
racunu budu izneli i to sve u roku od 15 dana po pravosnaznosti ove
presude a pod pretnjom prinudnog izvrsenja.

Puska model br.48 sa 30 metaka kao i jedan krevetski car=
saf,a koje je stvari ukrao optuzeni Mehaj Becir,od ostecenog Bimbase
Jusufa imaju se vratiti ovome.

O b r a z l o z e nj e

Javna optuzba stavila je na teret optuzenih krivicna dela
za koja je sud optuzene i oglasio krivim i kaznio kao u izreci ove
presude.

Svi optuzeni sem optuzenog Adem Alije u prethodnom postup=
ku u potpunosti su priznali da su izvrsili pretstavljena krivicna
dela koja su im stavljena na teret.Dok optuzeni Adem u prethodnom
postupku a i na pretresu priznaje da mu je optuzeni Bislim govorio
o formiranju ilegalne organizacije "Vujtet",ali da je on-optuzeni
Adem-navodno to smatrao neozbiljnim i provokatorskim,pa radi toga
da slucaj nije ni prijavio,niti pak da je postao clan ilegalne orga=
nizacije,pa je ovaj optuzeni molio sud da ga oslobodi.Optuzeni Bis=
lim,te optuzeni Mehaja,ovaj u odnosu na krivicno delo iz cl.117 st.2
Kz,te optuzeni Istref na glavnom pretresu porekli su priznanja data
u prethodnom postupku istina optuzeni Bislim ne u potpunosti,dok op=
tuzeni Serif i optuzeni Ramadan i na glavnom pretresu u potpunosti
su priznali da su postali clanovi ilegalne organizacije,da su za ovu
radili i na sastancima ucestvovali.

Branilac optuzenog Bislima ovd.adv.Blazo Stankovic u konac=
noj reci molio je za svoga branjenika blazu kaznu,isticuci da ranije
njegov branjenik nije neprijateljski delao,da je mladji covek i da
iz njegovog delanja nije proistekla nikakva stetna posledica.

Branilac optuzenog Adema ovd.adv.Zeca Arni u konacnoj reci
trazio je od suda da njegovog branjenika oslobodi od optuzbe,jer da

./.

nuk do të ishte nji gja e vlefshme as për popull mbasi populli mund të rrahen për këtë punë.

Ramadani, une e kam vrejt Brahim Murselin që jemi nën rrogë dhe me ka pyt pse nuk vjen rroga e jonë mbasi neve jemi met vertete shqiptar edhe spritoj me vdes aspak pers hipni.

I dashni Ramadan kallxoj: Në qoftëse bahemi afer 50 veta mundet me na mbrri rroga kurse me neve 5-7 veta ska as si me na mbrri rroga pa shkue me marr na vetë (kjo ka qenë përgjigje e ime e trilluese).

Mbledhja e pestë

1959

Proqes i mbajtun në takimin e mbajtun në odën e Sherifit. Marrin pjesë Une, Ramadan Keqa, Sherif Muslija e Istref Osmani.

Rendi i ditës: Përpunimi i Notës, Jugosllavisë- dërgue ambasadorit të Shqipënisë në Beograd.

Une kam lexue notën të shtypun në Rilindje e mbasandaj diskutimi rreth sajna.

Ramadan Keq diskuton: Të dashtun shokë a shifni që ata nga ana e jashtme vijn dhe futën në burg ketu dmth për popullin tonë e neve jemi ketu edhe nuk shpurthim aspak.

Istref Osmani: Neve jemi njerz të shtypun e nuk dimi asgja, a une jam kanë në ushtrin e Shipnis e prandaj e njoh fare mirë se çfare luftaresh ka në Shipni e prandaj edhe na ose qita djemt tonë me qenë atje në shkolla kishin me qenë të gatem në çdo hap me vdesë. Kurse neve kështu të shtypun edhe ende dihemi që jemi gjallë.

Ramadani:Neve asht shumë vështir me punue në nj iksi lloj vendi ku ka shumë spiun, por une kisha dhanë mendimin që çdo spiun i shpluem që përpikënisht i vërtetuem, që të zhdukim ne çdo menyë e dotë punojmi ma lehtë.

I dashtuni Ramadan une nuk ishem konë i mendimit me zhduk shqiptar, e do të vjen nji kohë që denohemi si Brahim Tërnavci e ma mirë vetëm i shplojm e gati po si të ishin të vramë.

Procesi mbetet ke Sherif Musliu, mbasi asht si ma i kujtuem.

Fund

Procesmbajtës Bislim Tahiri

Prokuroria Publike e Qarkut ne Prishtine ngrite aktakuze

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i kishte kërkua që në bazë të nenit 44 , alineja 2, pika 2 Ligji për veprimtari penale të ngrit akuzë kundër:

1. Bislim Bislimit, bujk nga Prekazi i Epërm, në të cilën edhe kishte lindur më 1933 nga babai Tahir dhe nëna Hanife e lindur Bilalli. I martuar por ende pa fëmijë. Me kombësi

shqiptar, qytetar i RSFJ. Dinë shkrim-lexim, ka të mbaruar një klasë të Normales. Ushtrinë e ka të mbaruar gjatë vitit 1953/55. Është i evidentuar në sektorin e ushtrisë në Mitrovicë të Kosovës. Gjendja ekonomike- e mesme, nuk është i dekoruar. Ka qenë i dënuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit të Serbicës me numër K. Br. 163/55 nga 25 tetori 1955, me dënim me burg prej 4 muajsh. Në burg ndodhet nga 14 prilli 1959.

2. Adem Alia, nëpunës nga Klina e Epërme. Ai me vitin 1926, po në këtë fshat kishte lindur nga babai Ali dhe nëna Zade e lindur Veliu. Gjendja familjare- i martuar, baba i një fëmije. Kombësia- shqiptar, qytetar i RSFJ-së. Di shkrim-lexim, ka të mbaruar dy vite gjimnaz. Ushtrinë e ka të mbaruar gjatë vitit 1944/48. Vjen nga një familje e varfër. Nuk është i dekoruar. Gjerë më tani nuk ishte i dënuar. Në burgun hetues ndodhet që nga 16 prilli 1959.
3. Sherif Musliu, bujk nga Prekazi i Epërm, ku është i lindur më vitin 1924 nga babai Muslia dhe nëna Ajmone e lindur Gjoshi. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. Shqiptar, Qytetar i RSFJ-së, di shkrim-lexim, ka të mbaruara 4 klasë të shkollës fillore. Shërbimin ushtarak e ka kryer gjatë periudhës 1954. Mesatarisht i pasur. Nuk është i dekoruar. I pa dënuar. Në burgun hetues ndodhet që nga data 15 prill 1959.
4. Beqir Mehaj, bujk nga Prekazi i Poshtëm. Ka lindur më vitin 1936 nga babai Nebi dhe nëna Hanife e lindur Vojvoda. Është i martuar, baba i një fëmije. Shqiptar me nënshtetësi jugosllave, analfabet, ushtrinë nuk e ka të kryer, fizikisht ishte i pa aftë. Gjendja ekonomike- është i varfër. Nuk është i dekoruar. I pa dënuar. Në burgun hetues ndodhet që nga data 15 prill 1959.
5. Ramadan Zeneli, bujk nga Prekazi i Epërm. Është i lindur po në këtë fshat më 1915 nga babai Zenel e nëna Zarife, e lindur Bislimi. Është vejan, baba i 2 fëmijëve. Shqiptar, me nënshtetësi jugosllave. Dinë shkrim lexim, ka të mbaruar 4 vjet të shkollës fillore. Ushtrinë e ka të mbaruar më 1937. Ekonomikisht i varfër. Nuk është i dekoruar dhe i pa dënuar. Në burgun hetues ndodhet që nga 20 prilli 1959.
6. Istref Hasani, bujk nga Prekazi i Epërm. Është i lindur më 1925 nga babai Osman dhe nëna Razë e lindur Tahiri. Është i martuar, baba i 3 fëmijëve. Shqiptar me nënshtetësi jugosllave, din shkrim lexim- autodidakt. Ushtrinë e ka të përfunduar gjatë viteve 1944/47. I varfër ekonomikisht. Nuk është i dekoruar dhe i dënuar. Në burgun hetues ndodhet që nga data 20 prill 1959.

131

ganizacije.Da je na sastancima vodio zapisnik i davao konkretna za=
duzenja clanovima,da je na jednom sastanku optuzeni Muslija predla=
gao rusenje bandera,mostova i drugo a optuzeni Ramadan Zejnel da je
predlagao ubijanje sluzbenika Udbe i njihovih saradnika,ali da se
on-optuzeni Bislim-sa tim nije slozio rekavsi da jos za to nije vre=
me,da je na sastanku dato zaduzenje da svi clanovi nastoje da prona=
dju nove clanove,ali verne i pouzdane,da je u tom cilju optuzeni Ra=
madan priveo optuzenog Istrefa i da je optuzeni Istref obecao prona=
ci druge clanove svoje prijatelje a takodje i optuzeni Mehaja Becir
da je obecao pronaci i pridobiti za organizaciju svoje prijatelje,a
uz to da je optuzeni Mehaja dobio zadatak da za organizaciju prona=
dje i pusku odnosno da ovu iz stana Bimbase ukrade,sto je konacno op=
tuzeni Becir i ucinio i obivsi stan ostecenog Bimbase ukrao pusku sa
30 metaka a pored toga da je ukrao i jedan carsaf iz kuce ostecenog
Bimbase.

Optuzeni Ramadan i optuzeni Serif i u prethodnom postupku
a i na pretresu u potpunosti su priznali da su pristupili neprijate=
ljskoj organizaciji ciji je bio rukovodioc optuzeni Bislim,da ih je
ovaj upoznao sa zadacima a naime,da se treba boriti svim silama da
se Kosmet otcepi iz sastava FNRJ i priljuci Albaniji.Ovi optuzeni
priznaju da je na sastancima optuzeni Bislim vodio zapisnik,da je na
sastanku prisustvovao i optuzeni Istref,da su oni i to optuzeni Rama=
dan predlagao ubijanje saradnika Udbe a optuzeni Muslija da je pred=
lagao rusenje telefonskih stubova,mostova i t.d.ali da se sa tim ni=
je slozio rukovodilac-optuzeni Bislim.

Optuzeni Alija Adem na prvom saslusanju u prethodnom postu=
pku nije priznao nista u vezi sa radom organizacije.Na drugom saslu=
sanju u prethodnom postupku,pa i na pretresu priznaje da mu je optu=
zeni Bislim,kao sestric,negde u 1958 godini prilazio i da mu je pome=
nuo da je formirao neprijateljsku grupu za borbu za ocepljenje Kosmeta
iz sastava FNRJ i pripajanje ovoga Albaniji,ali da on-optuzeni Adem-
je to navodno shvatio kao salu a kasnije da je mislio da se radi o
provokaciji pa da o tome nije nikoga obavestio,inace priznaje da je
neku hartiju davao optuzenom Bislimu,ali da mu optuzeni Bislim nije
rekao da ta hartija treba da sluzi za vodjenje zapisnika na tajnim
sastancima organizacije,ma da tako optuzeni Bislim u prethodnom pos=
tupku je tvrdio.

Optuzeni Zejnel,te optuzeni Ramadan i Istref tvrde da je na
sastancima optuzeni Bislim govorio da je i optuzeni Adem sa njima i
kako je dobio poseban zadatak za otkrivanje saradnika Udbe u nekim
selima.

./.

Në burgun hetues ndodheshin për këtë arsye:

I.

Bislim Bislimi, i cili gjatë vitit 1958 në rrethinën e rrethit të Mitrovicës së Kosovës ka formuar organizatën ilegale të quajtur "Vuajtja", e cila kishte për qëllim që nëpër mes të forcës të ndajnë Kosovën nga Jugosllavia për t'a bashkua me Shqipërinë. Dhe mu për këtë qëllim në radhët e saja ka pranuar e angazhuar shumë persona që më 1958 ka mbajtur shumë mbledhje në të cilat ka folur për detyrat e organizatës dhe masivizimin sa më të madh të njerëzve për të luftua kundër sistemit aktual në Jugosllavi. Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë ka ardhur në përfundim se me këtë ka bërë vepër penale në bazë të nenit 117, alineja 1. të Ligjit Penal të Jugosllavisë.

II.

Adem Ademi, që në ditën e muajin e pavërtetuar, gjate vitit 1958 është bërë anëtar i organizatës ilegale "Vuajtja", të cilën e kishte formuar Bislim Bislimi. Bislimi llogaritej njeri me eksperiencë dhe kishte respekt te fshataret. Andaj duke u nisur nga kjo edhe numri i të interesuarve për të qenë anëtar të saj ishte i madh. Po ashtu edhe Adem Ademi akuzohej në bazë të nenit 117, alineja 2, të LPJ.

III.

Sherif Muslija, Beqir Meha, Ramadan Zeneli dhe Istref Osmani, në fund të vitit 1958 ishin bë anëtar të organizatës ilegale "Vuajtja" të cilën e kishte formua Bislim Bislimi në të cilën kishin marr pjesë në shumë mbledhje të organizatës, ku ishte diskutua gjerësisht për organizimin dhe masivizimin e anëtarësisë. Ata pas anëtarësimit në organizatë kishin zhvillua aktivitet të dendur në terren duke u takua me shumë persona, tek të cilët kishin pas besim. Edhe këta ishin akuzua në bazë të nenit 117, alineja 2 të Ligjit Penal të Jugosllavisë.

Beqir Meha ishte akuzua edhe për shkak të marrjes së pushkës në mes të datës 23-24 mars 1959, nga banesa e mësuesit Jusuf Bimbashit, duke e thyer dritaren dhe grabitur pushkën për interesa të organizatës, bashku me të kishte marr edhe 30 fishek dhe një çarçaf për të mbështjell pushkën.

Në bazë të të dhënave që u thanë më lart, Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë propozon që para kësaj gjykate të mbahet seanca gjyqësore në të cilën do të thirren të akuzuarit nga burgu hetues të sillen në gjykatë. Po ashtu të thirren dëshmitarët: Muhamet Qerimaj, punëtor nga Mitrovica; Maliq Brahimi, bujk nga Prekazi i Epërm; Tahir Meha, bujk nga Prekazi i Poshtëm; Jusuf Bimbashi, mësues nga Prekazi i Epërm, Abaz Zenunu, nga Këqiqi i Madh,; Sadri Shosholli, nga Këqiqi i Madh; Shaqir Rrahmoni nga Luboveci, Cenë Fejza e Ajet Meha nga Prekazi i Poshtëm.

Në ditën e seancës gjyqësore të lexohen: (prijave), e stacionit policor në Serbicë me nr. 1/6 nga 24 marsi 1959; procesverbali nga pretres shtëpia e Beqir Mehës dhe shikimi në dokumentacionin me nr. 1470 nga data 4 maj 1959 nga libri "Operacioni Cicero", të cilën i akuzuari Adem ia kishte dhënë për lexim Bislim Bislimit.

Arsyetimi që jepet nga prokuroria del se gjatë hetimeve se, situata e tanishme është: gjatë hetimeve del se Bislim Bislimi nuk ishte aktiv vetëm në vitin e fundit, por konstatohej që nga viti 1951 ai qysh si nxënës ishte përjashtua nga shkolla normale në Gjakovë, ngase kishte këndua këngë me përmbajtje nacionaliste. Më 1955 ishte dënua përsëri me 4 muaj burg për arsye të angazhimit të tij në veprimtari antishtetërore. Po ashtu më 1958 ai formon një organizatë patriotike ilegale të pagëzuar me emrin "Vuajtja", ngase shqiptarët në Jugosllavi nuk gëzonin asnjë të drejtë veçse vuanin nga okupuesi. Organizata në fjalë për qëllim kishte shkëputjen e Kosovës nga Serbia e Jugosllavia dhe bashkimin e saj me Shqipërinë.

Fillimisht, Bislimi kishte bisedua me Ademin, se e dinte se ai ishte një njeri i shkolluar dhe me përvojë organizative dhe kishte një përvojë politike dhe mbi të gjitha e dinte se edhe ai ishte i pakënaqur me qëndrimet e pushtetit jugosllav ndaj shqiptarëve. Ademi menjëherë kishte pranua me qenë anëtar i organizatës dhe ishte angazhua me të madhe rreth organizimit, veprimit dhe masivizimit të organizatës me anëtarë të rinj. Në mes tjerash iu kishte dhënë këshilla se si duhet të punojnë me njerëz dhe se si duhet të mbahen mbledhjet me anëtarët. Ademi kishte propozua që kryesisht mbledhjet të mbahen ne treshe ngase gjatë punës partizane janë tregua shumë të suksesshme dhe ka pasur shumë vështirësi që të zbulohen anëtarët e tjerë të lëvizjes. Për ta bindur Bislimin se kjo formë e punës është e aplikueshme, ai në besim i kishte dhënë Bislimit librin "Operacioni Cicero".

Duke u frymëzuar nga urrejtja ndaj okupuesit, Bislimi angazhon edhe shumë të tjerë në organizatë. Rregullisht mbante mbledhje dhe konsultohej me ta. Bile në një mbledhje kishte kërkua që është mirë që anëtarët e organizatës të armatoseshin se në rast nevoje do të vije koha edhe për armatim. Mu nga kjo lind ideja që kishte qenë mirë që dikush nga anëtarët e grupit të merrte pushkën në shkollën e fshatit Prekaz i Epërm dhe t'i dorëzohej organizatës. Në natën në mes 23/24 marsit, Beqir Meha duke e ditur se në këtë natë shkolla e fshatit është e zbrazët, ai organizon grabitjen e saj. Kontribut të

madh në këtë kishte dhënë edhe vëllai i vogël i tij- Tahir Mehaj, i cili e kishte shoqërua



-14- 138

zeo kao olaksavajuce okolnosti porodicne i materijalne prilike, delimicna priznanja, zdravstveno stanje svakog ponaosob a optuzenom Bislimu sud je uzeo kao otezavajucu okolnost da je delo ucinio u povratu, pa obzirom na sve ove okolnosti, te drustvenu opasnost ucinioca i dela sud je optuzenima odmerio kazne kao u izreci s tim sto je optuzenom Beciru primenom cl.46 Kz odmerio pored pojedinacnih kazni za svako delo jednu ukupnu povisenu kaznu kako je to za njega i naznaceno, pa obzirom na iznete okolnosti, te drustvenu opasnost ucinioca i dela sud je optuzenima odmerio kazne kao u izreci ove presude, jer sud nalazi da izrecene kazne u konkretnom slucaju odgovaraju i da ce se njima postici svrha kaznjavanja-cl.3 Kz.

Obzirom da su svi optuzeni oglaseni krivim a da su srednjeg imovnog stanja to ih je sud a shodno cl.88 i 90 st.1 Zkp imao i obavezati na placanje pausala, te ostalih troskova krivicnog postupka kako je to u izreci ove presude u tom delu navedeno.

Posto nije sporno da puska model br.48 sa 30 metaka kao i jedan krevetski carsaf pripadaju ostecenom Bimbasi Jusufu od koga je ove stvari optuzeni Becir putem provalne kradje ukrao to je valjalo i odluciti da se ove stvari ostecenom Bimbasi imaju i vratiti.

Sa svega napred izlozenog valjalo je i odluciti kao i u izreci ove presude.

OKRUZNI SUD U PRISTINI, DANA 1 jula 1959 god. K-br.104/59.

Zapisnicar, Pretsednik veca-sudija,
/Jagoda Aleksendric/ /Vujo Rakocevic/

POUKA O PRAVNOM LEKU: Protivu ove presude nezadovoljna stranka ima pravo zalbe u roku od 8 dana od dana prijema ove presude Vrhovnom sudu NR Srbije, a preko ovoga suda.

Експедовано дана 10-VII-59

1 прим. пресуде } Окр. јав. туж. Прист.
1 доставница }

-//- -//- } адв. Б. Станковићу за опт. Бислима
-//- -//- }

-//- -//- } адв. Зеки за опт. Алију
-//- -//- }

-//- -//- } адв. Поповићу за остала 4 оптужена
-//- -//- }

Ј. Алексендрић

vëllanë dhe kishte bërë roje derisa ky e kishte marr pushkën me 30 fishek.

Gjatë hetuesisë ishte konstatua se shumica e anëtarëve të organizatës e kishin pranua veprimtarin e tyre atdhetare dhe veten e ndjenin krenar që kishin arritur që të sensibilizonin situatën okupuese aktuale tek populli shqiptar në rrethinën e rrethit të Serbicës e të Mitrovicës. Ata nuk mohuan asgjë nga angazhimet e tyre por edhe nuk u penduan për aktivitetin e tyre që kishin zhvillua.

Arsyetimin e kishte nënshkrua Zëvendës Prokurori Publik i qarkut të Prishtinës, Miroslav Lazareviq. Me datë 3 qershor 1959.

Procesi kryesor gjyqësorë

Në bazë të urdhëresës për procesin kryesor, u mor qëndrimi që ai të mbahej me 30 qershor 1959 në orën 8 të mëngjesit.

Në proces duhet të merrnin pjesë: Prokurori Publik i Qarkut të Prishtinës; te gjithe te akuzuarit që ndodhen në burgun hetues; Avokati mbrojtës i palës- Stoilkoviq Papoviq; Duhet thirrur të gjithë personat sipas propozimit që ndodhen në aktakuzë; Duhet kërkuar të gjitha të dhënat për gjendjen materiale të të akuzuarve, po ashtu duhet thirr përfaqësuesin e entit të Sigurimeve Sociale. Urdhëresa iu kishte dorëzua që të gjithëve me datë 10 qershor 1959, nga Kryetari i Këshillit, gjykatësi, Vujo Rakoqeviq[5]. Gjatë bastisjes që ishte bë në shtëpinë e Bislim Bislimit, organet hetuese në shtëpinë e tij kishin gjetur 7 tabak letër, të cilët u gjetën në banesën dhe në lokale të tjera të Bislim Bislimit. Letra që ishte gjetur te i akuzuari ishte pronë e Kooperativës Bujqësore në Klinën e Epërme, me të cilën arkëtari i saj Adem Gjemë Alia i kishte dhanë udhëheqësit të organizatës ilegale Bislim Bislimit me qëllim që të mbante procesverbalin e mbledhjeve të organizatës "Vuajtja" dhe për ndonjë shënim tjetër.[6]

Procesverbali nga seanca kryesore e grupit

Procesverbali i seancës kryesore ishte mbajtur me 30 qershor 1959 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër 6 të akuzuarve në bazë të nenit 117, alineja 1 e 2 të LPJ dhe nenit 250. Alineja 2 të Ligjit Penal, në bazë të dokumenteve Kto-83/59 me 2 qershor 1959. Në seancë kishin marr pjesë Kryetar i Këshillit gjyqësor: Vujo Rakoqeviq, Gjykatësi Dragutin Kalugjeroviq , gjykatësit porotë: Mehmet Kalaveshi, Qazim Bajgora dhe Riza Voca. Procesmbajtës Jagoda Aleksandriq.

[5] Urdhëresa e PPQ, nr. .K. 104/59.
[6] K. U. 102/59

Në seancë merrte pjesë edhe Zëvendësi i Prokurorit Publik të Qarkut në

Бр. _____

_____ 194 ___ год.

у _____

59

ПОДАЦИ О ОКРИВЉЕНОМ

1	Презиме и име окривљеника Име оца и мајке Девојачко презиме мајке	MUSLIJA SHERIF, Sejdija i majka Ajmane, r. rodj. Ljošaj.
2	Надимак окривљеног	-
3	Пол	muško
4	Дан, месец, година, место, срез и народна република рођења	10-XII-1924 godine s.Gor.Prekaze Srbija
5	Место боравишта до оптужбе	selo Gornje Prekaze
6	Раније и садање занимање	zemljoradnja
7	Народност и држављанство	Šiptar FNRJ
8	Имовно стање (величина и вредност непокретне имовине, вредност покретне и целокупне имовине). Колико лица издржава	siromašna, 5 Hektara obrad. zemlje i 1,50 Ha, šume, vred. 500.000 din. 1 kuća i 1-nda štala (kuća nije još dovršena dvaspratna) vred. 100.000 d. Ukupna vred. 600.000 din. izdržava još 4 članova porodice.
9	Породично стање: ожењен односно удата, неожењен односно неудата, разведен, одвојено живећи и име жене односно мужа, колико има година, имена деце (брачне и ванбрачне), колико имају година	oženjen, otac dvoje dece, i to: Ajmana rodjena 1954 godine i Ševdija rodjena 1957 godine. NAPOMENA: ovaj ima pored ove ovih još oca i ženu svega su 5 u domać.
10	Писменост	Pismen
11	Опште образовање (врсте школе)	završio 4 razreda osnovne škole
12	Да ли је раније осуђиван	nije
13	Физичка способност: здравствено стање, физички недостаци, способност за рад тежи-лакши, способност специјалног стручног рада итд.	Sposoban

II СОЦИЈАЛНИ ПОЛОЖАЈ

1	Индустриски радник	-
2	Пољопривредни радник	-
3	Остали физички радници	-
4	Земљорадник: ситни, средњи, крупни посједник	da
5	Трговац	-
6	Занатлија	-
7	Приватни намештеник	-
8	Остале слободне професије	-
9 а	У органима државне управе	-
9 б	У држ. привредним предузећима локалног значаја	-
9 в	У држ. привредним предузећима опште држ. и републ. значаја	-
10	Без посла и занимања	-

Sef

Секретар, Mesne kancelarije, Претседник Народног одбора.

Prishtinë, Miroslav Lazareviq. Po ashtu edhe të akuzuarit: Bislim Bislimi, Adem Alia, Sherif Muslia, Beqir Meha, Ramadan Zeneli dhe Istref Osmani. Avokati mbrojtës

Blazho Stankoviq, ishte në cilësinë e mbrojtësit të Bislim Bislimit, Avokati Zeqir Arrni, mbronte Adem Alin dhe avokati Jovan Popoviq ishte mbrojtës i të akuzuarve të tjerë.

Qysh më herët ishte marr vendimi që seanca gjyqësore të mbahej publikisht dhe të fillonte me 30 qershor në ora 8 të mëngjesit. Pasi se ishte lexua aktakuza, Kryetari i Këshillit gjykues kishte urdhërua që të ngel vetëm i akuzuari Bislim Bislimi.

Fillimisht Bislimi kishte deklarua se të gjitha deklaratat që i kishte dhënë para hetuesve ishin të sakta dhe iu kishin lexua atij para se të nënshkruante. Ajo që e kishte detyrua që të formonte organizatën ilegale ishte varfëria e skajshme dhe padrejtësitë e shumta ndaj tij dhe shqiptarëve. Në fund kishte deklarua se qëndron pas të dhënave që i kishte deklarua më herët. Edhe pse kryetari i këshillit gjyqësor e provokonte me pyetje të ndryshme, megjithatë ai nuk kishte rënë në grackë për të tregua për shokët. E kishte mbrojtur me këmbëngulje Adem Alin, duke thënë se ai asnjëherë nuk ka qenë anëtarë i organizatës.

2. Adem Alia kishte deklarua se edhe ai qëndronte prapa deklaratave që i kishte dhënë në hetuesi. Ai ishte marr dy herë në organet e hetuesisë dhe përafërsisht i kishte thënë të njëjtat gjëra. Në të njëjtën kohë edhe gjatë ballafaqimit, ai kishte dëshmua për të njëjtat çka edhe ishte pajtua edhe Bislim Bislimi.

3. Gati që të gjithë të arrestuarit ishin marr në pyetje nga dy herë, por dallimi në rrëfimet e tyre nuk dallonte dhe se ishin identike me njëri tjetrin. Edhe Sherif Muslia kishte deklaruar se nuk ka se çfarë të ndryshojë ngase edhe në hetuesi e kishte thënë të vërtetën dhe qëndronte pas saj.

4. Beqir Meha, edhe ky si të tjerët kishte deklarua se të gjitha çfarë di dhe se çfarë ka bërë i ka thënë në hetuesi, deklaratën e ka lexuar dhe qëndron pas saj.

5. Ramadan Zeneli përgjigjet shkurt duke thënë se të gjitha çfarë ka thënë me datë 20 prill dhe 16 maj para hetuesisë deklaron se janë të sakta dhe për këtë nuk ka se çfarë të ndërrojë.

6. I vetmi Istref Osmani nuk e kishte pranua deklaratën e mëhershme ngase kryetarit të Këshillit gjyqësor i kishte thenë se "Deklaratën e ka dhënë dhe e ka nënshkrua nën presion të hetuesve që e kanë marr në pyetje". Deklaratën që e japi sot, këtu para jush, kjo është e vërteta e të tjerat ato të mëhershmet janë shpifje dhe të pavërteta. Ndërsa në këtë kundërshtim të Istrefit, Bislim Bislimi kishte reaguar se me të vërtetë atë që thotë Istrefi sot është e vërtet ndërsa deklarata e mëhershme para hetuesve ka të pavërteta. Pas kësaj bisede që të gjithë të akuzuarit u pajtuan me deklaratën e Istrefit.

Dita e dytë e seancës gjyqësore

Pasi se dita e punës ishte në fund, kryetari i Këshillit të gjyqit, mori vendim që të ndërpritet seanca për të fillua nesër që nga ora 7 e mëngjesit me përbërje të njëjtë dhe në ditën e nesërme të shpallet vendimi i Gjyqit.

Me 1 korrik, 1959, në sallën e gjyqit të Qarkut në Prishtinë, në ora 7 të mëngjesit kishte fillua pjesa e dytë e seancës gjyqësore. Në këtë pjesë morën pjesë të gjithë dëshmitarët e ftuar si : 1. Muhamet Qerimi, 2. Maliq Brahimi, 3. Tahir Meha, 4. Jusuf Bimbashi, 5. Shaqir Rrahmoni, 6. Zenë Fejza, 7. Ajet Meha, 8. Sadri Shosholli dhe 9. Abaz Zenuni.

Veç Tahir Mehës, i cili njëherë ishte edhe vëllai i Beqir Mehës i cili nuk kishte deklarua asgjë, ngase ligji i mundësonte një gjë të tillë për mos deklarim ngase lidhjet familjare e lejonin që të mos deklarohet, të gjithë të tjerët u deklaruan dhe qëndruan pran deklaratave të tyre të mëparshme.

Kryetari i Këshillit të gjyqit pasi i prezantoi dokumentacionin që e kishte me vete, lexoi të gjitha të dhënat e të akuzuarve, gjithashtu u lexua raporti i stacionit të policisë në Serbicë nga 24 marsi 1959; u lexua procesi i gjetjes së pushkës; proceset e më parme gjyqësore që ishin ndaj Bislim Bislimit. U prezantuan të gjitha të dhënat rreth këtij procesi gjyqësor, andaj në pyetjen e gjykatësit se a mos kishin me shtua diçka tjetër të pranishmit, ata u deklaruan se pajtoheshin me të dhënat dhe nuk kishin se çfarë të ndryshonin.

Fjala e avokatëve mbrojtës:

Përfaqësuesit mbrojtës të të akuzuarve në fund të seancës gjyqësore kishin deklaruar se : edhe gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarve, vërehej se të akuzuarit kishin qenë shumë të sinqertë dhe konsekuent gjatë përgjigjes para Këshillit gjykues që përpikërish këto deklarata përputheshin edhe me deklaratat e marra në hetuesi. Avokati i Bislim Bislimit, Blazho Stankoviqi kishte deklaruar se "klienti im, Bislim Bislimi dhe të tjerët qysh në fillim të lënë përshtypjen e njerëzve inteligjent. Kjo ndodhë për shkak të sistemit shoqëror në vendin ton, andaj duhet të jemi mirënjohës. Klienti im qysh si i ri ka mbetur pa shkollë, pa punë, familja e madhe që është dashur të kujdeset për ta, gjendja materiale e familjes ka qenë shumë i varfër" dhe kjo sipas avokatit ka qenë arsyeja që e ka detyruar që të marri rrugën e gabuar. Nga veprimtaria e tij në shoqëri nuk ka pasur kurrfarë pasojash edhe s'ka mundur të ketë ngase se shoqëria e jonë socialiste ka qenë shumë e fortë dhe e pathyeshme. Edhe pse veprimtaria si qëllim ka pasur qëllime antishtetërore, avokati mendonte se nga ato qëllime asnjëra nuk ka

mundur të realizohej dhe mu për këtë qëllim duhet Bislim Bislimit duhet shqiptuar masa sa më e vogël e dënimit, se edhe çfarëdo mase që të jetë do të ndikoi pozitivisht në të.

Edhe avokati i Adem ... Zeqir Arrni, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbrojtësi i tij si në deklaratat e dhëna gjatë hetuesisë po ashtu edhe tani para trupës gjykuese nuk pranon se ka qenë anëtarë i organizatës ilegale. Gjithashtu asnjëri nga të akuzuarit nuk ka dëshmua se Ademi ka qenë anëtar i organizatës. Edhe ata që kishin deklarua më herët se ai ishte anëtar, e mohuan kategorikisht dhe nga kjo del se Ademi kishte bisedua me Bislimin, për metodat e punës së luftës partizane, por anëtar i asnjë organizate nuk kishte qenë. Ndoshta edhe do të ishte normale kur dikush shpif për të se ka qenë armik i shtetit, por e dimë se ai për shumë vite kishte qenë në vende të rëndësishme dhe është e mundur që ndonjë personi edhe i ka bë ndonjë të keqe pa vetëdije dhe tani po ata persona duan që ti hakmerren duke shpifur gjëra të pavërteta." Avokati në fund të fjalës përfundimtare kishte kërkua nga gjykatësi që Ademin ta lironte si të pafajshëm.

Ndërsa avokati mbrojtës i Muslijes, Mehës, Zenelit e Istrefit në fjalën e tij kishte thënë se nga vet udhëheqësi i organizatës Bislim Bislimit duket çart se ai në kohën kur vepronte ka qenë politikisht i pa pjekur dhe i ngarkuar politikisht nga vet situata. Ai në kohë të vështira ka kërkua njerëz që të punonte ndoshta edhe për të shfry mllefin ndaj vet jetës. Ndërsa sa i përket veprës së Beqir Mehës që ka bërë marrjen e pushkës, t'i shqiptohet dënimi sa më i vogël, ndërsa klientëve të tjerë si Muslijes, Zenelit, Istrefit po ashtu edhe Mehës, për vepër penale nga neni 117, alineja 1, e 2, të mos iu shqiptohet kurrfarë dënimi ngase me asgjë nuk vërtetohet se kanë kryer vepër penale.Pas kësaj Këshilli i gjyqit tërhiqet për të shqyrtua dhe votua për veprat e tyre.

Me 1 qershor 1959, Kryetari i Këshillit të Gjyqit të Qarkut në Prishtinë, para të pranishmëve lexon Vendimin në Emër të Popullit:

Të akuzuarit Bislim Bislimi, Adem Alia, Sherif Muslia, Beqir Meha, Ramadan



Zeneli dhe Istref Osmani me të gjitha të dhënat si dhe dokumentacionin qe e posedon gjykata:

Shpallen Fajtor:

Për këto arsye:

1. Bislim Bislimi për shkak se gjatë vitit 1958 në rrethinën e Rrethit të Mitrovicës kishte formua organizatën ilegale me emrin "Vuajtja", e cila kishte për qëllim që nëpër mes të forcës ta shkëpus Krahinën Autonome të Kosovës e Metohisë nga RSFJ-ja për qëllim që t'ia bashkëngjitet Shqipërisë. Mu për këtë arsye ka anëtarësuar shumë persona për të veprua kundër shtetit sidomos gjatë vitit 1958 dhe vitit 1959. Gjatë kësaj periudhe kishte mbajtur disa mbledhje me ta, në të cilat ishte diskutua dhe ishin marr shumë vendime të rëndësishme si masivizimi i shtuar i anëtarëve në organizatë si dhe zbulimi i bashkëpunëtorëve të UDB-es dhe furnizimi me armatim të anëtarëve të grupit. Me anë të kësaj që u tha më lart konstatohet se Bislim Bislimi ka kryer vepër penale për bashkim kundër shtetit dhe popullit sipas nenit 117, alineja 1. Të L.P.
2. Adem Alia në ditën e muajin e pa caktuar gjatë vitit 1958 është bërë anëtar i organizatës ilegale "Vuajtja", të cilën e kishte formua Bislim Bislimi. Duke e ditur se ai kishte eksperiencë më të madhe politike , ai edhe ishte caktua udhëheqës i organizatës dhe po ky i kishte udhëzuar ata se si të punohet dhe se si të përfitohen sa më shumë persona për t'u anëtarësuar në organizatë. Po edhe ky ka kryer vepër penale politike për bashkim kundër shtetit dhe popullit në bazë të nenit 117, alineja 1, 2 të LP.
3. Po ashtu edhe personat Sherif Muslia, Beqir Meha, Ramadan Zeneli dhe Istref Osmani, të gjithë këta në fund të vitit 1958 janë anëtarësua në organizatës ilegale "Vuajtja" të cilën e udhëhiqte Bislim Bislimi, gjithashtu kishin marrë pjesë në shumë mbledhje të organizatës në të cilat ishte njoftua për detyrat dhe qëllimet e saja. Duhet përmendur se kontribut të madh kishin dhënë në masivizimin e organizatës me anëtarë të rinj duke iu ofruar shumë personave bashkëpunim dhe njohuri për organizatën dhe duke folur haptas për padrejtësitë e shumta që bëheshin ndaj shqiptarëve nga ana e serbëve e malazezëve që ishin në pushtet.
4. Po ashtu edhe këta akuzoheshin në bazë të nenit 117, alineja 1 e 2 të Ligjit Penal të Jugosllavisë.

   Në bazë të të dhënave dhe veprimtarisë së tyre në organizatën ilegale vije në përfundim se të akuzuarit dënohen:

1. Bislim Bislimit i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh, dënim i cili i llogaritet që nga 14 prilli i vitit 1959, respektivisht që nga dita kur edhe është arrestua.
2. Adem Alia, dënohet me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burg të rëndë. Burgu i llogaritet që nga dita e arrestimit nga 16 prilli 1959.
3. Sherif Muslia dënohet me 2 (dy) vjet burg të rëndë. Dënimi i llogaritet që nga dita e arrestimit 15 prilli 1959.
4. Beqir Meha dënohet për vepër penale nga neni 117, alineja 2 të L.P. me 1 vit e gjysmë burg të rëndë. Ndërsa për grabitjen e pushkës nga shkolla fillore në Prekazin e Epërm nga neni 250, alineja 2 të L.P. me dënim të rëndë në kohë zgjatje prej 1 (një) viti burg. Gjyqi duke i pasur parasysh të gjitha aktivitete dhe veprimtarin e tij, i shqipton një dënim të përgjithshëm për të dy veprat dhe e dënon me 2 (dy) vite burg të rëndë duke filluar që nga dita kur edhe ishte arrestuar 15 prilli i vitit 1959
5. Ramadan Zeneli dënohet me 2 (dy) vite burg të rëndë duke pasur për bazë ditën e arrestimit të 20 prillit 1959.
6. Istref Hasanit, Gjykata e Qarkut në Prishtinë i shqipton dënimin prej 1 viti e gjysmë, duke filluar që nga 20 prilli 1959.

Në fund Gjykata e qarkut të akuzuarve i dënon me gjobë në të holla që të paguanin nga 500 dinar për nevoja të procesit gjyqësor në formë të paushallit. Parat duhet të paguheshin brenda 15 ditësh. Ndërsa pushka e marr nga Jusuf Bimbashi, mësues nga fshati Llaushë, duhet ti kthehet atij bashku me fishekët dhe çarçafin.

Në dokumentacionin e të akuzuarve ndodhet edhe procesverbali i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor se si ata kishin votua më 1 korrik të vitit 1959.

Për përgjegjësin politike të të akuzuarve të gjithë anëtarët porotë kishin votua një zëri se të gjithë të akuzuarit ishin fajtor dhe duhet dënuar me burg të rëndë.

Mehmet Kalaveshi kishte votua për përgjegjësin politike nga neni 117 të L.P. po ashtu edhe ishte pajtua që t'i shqiptohet edhe dënimi me burg Bislim Bislimit prej 5 viteve. Po ashtu edhe për të akuzuarit e tjerë. Edhe Qazim Bajgora kishte votua njësojë si porota e parë. Gjithashtu edhe Riza Voca voton njësojë si dy porotë e parë. Gjithashtu këtyre iu bashkëngjitet edhe anëtari i katërt, gjykatësi Dragutin Kalugjeroviq e kryetari i Këshillit Gjyqësor Vuja Rakoqeviq.

Votimi përfundon në orën 12 e 30 minuta.

Ankesat e të akuzuarve

Pas përfundimit të procesit kryesor gjyqësor dhe pas shqiptimit të dënimeve me burg, të akuzuarit kishin të drejt ankese. Kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me numër 104/59 nga 1 korriku 1959, bënin ankesë: Bislim Bislimi, Adem Alia, Sherif Muslia, Beqir Meha, Ramadan Zeneli dhe Istref Hasani nga fshati Prekaz i Eperm, i Poshtëm, Klina etj. Ata bënin ankesë në Gjykatën Supreme të RSF të Serbisë në Beograd

Avokati i katër të akuzuarve në ankesën që e kishte shkrua për Gjykatën Supreme në Beograd në mes tjerash shkruante se : "Nuk është bash gjithçka sikurse thuhet në vendimin e shkallës së parë në Prishtinë. Për shembull, vihej në përfundim se këta persona kanë formuar një Bandë, gjë që nuk është e vërtet, Ata nuk kanë formua dhe nuk ka veprua si e tillë. Askush prej personave nuk është arratisë dhe nuk ka kryer vepra penale".

Pastaj thuhej se kanë marrë qëndrime për të likuiduar persona bashkëpunëtor të UDB-es,por asnjëherë nuk është marr ndonjë veprim i tillë. Pastaj akuzohen se kanë "marr qëndrim që Kosovën ta shkëpusin nga Jugosllavia për ta bashkuar me Shqipërinë", por ata nuk mund të akuzohen për një gjë të tillë ngase asgjë nga ajo nuk është realizua..

"E vërtetë është se në mbledhjet e tyre është biseduar që të rrëzojnë banderra të telefonit dhe të rrymës elektrike, por asnjëherë nuk u arrit ndonjë bashkërendim dhe asnjëherë nuk u krye ndonjë vepër e tillë" kishte shkrua avokati. Kjo vepër ka të bëjë me Ramadanin dhe Sherif Musliun.

Sa i përket Beqir Mehës është e ditur se ai nuk ka marr pjesë në asnjë mbledhje të organizatës, askënd nuk e ka bind që të bëhej anëtar i saj dhe askënd nuk e akuzon se e ka bind për me u anëtarësua në organizatë.

Per Istref Hasanin askush gjatë seancave nuk ka thënë se ai ka qenë anëtar i organizatës. Edhe dëshmitari Muhamed, tregon se Istrefi nuk kishte pranua me qenë anëtar i organizatës andaj del se klienti im është i pafajshëm.

Andaj, avokati mbrojtës kishte shkrua ne ankesën e tije se " lusë gjykatën e lartpërmendur që të akuzuarve tu hiqet dënimi apo t'iu shqiptohet dënim simbolik, se në bazë të të dhënave personat në fjalë janë të pafajshëm".

Ankesa ishte dorëzua me 13 korrik 1959. Ndërsa e kishte nënshkrua avokati



ОКРУЖНО ЈАВНО ТУЖИОШТВО
Бр. 83/59
2.4 1959 год.
ПРИШТИНА

OKRUŽNOM SUDU

PRIŠTINA

Na osnovu čl.44 st.2 t.2 Zakonika o krivičnom postupku

O P T U Ž U J E M

1. BISLIMA BISLIMA, zemljoradnika iz G.Prekaza, gde je i rodjen 193[illegible] god. od oca Taira imajke Hanife rodj.Biljalj, oženjen, bez dece, Šiptar, državljanin FNRJ, pismen-završio 4 razreda učitelj ske škole, vojsku služio 1953/55 god. vodi se u vojnoj evidenciji ko Vojnog otseka u Kos.Mitrovici, srednjeg imovnog stanja, nije odlikov osudjivan presudom Sreskog suda u Srbici K.br.163/55 od 25.X.1955 go na kaznu zatvora u trajanju od 4 meseca zbog krivičnog dela pronevere u istražnom zatvoru od 14 aprila 1959 godine.

2. ADEMA ALIJU, službenika iz D.Kline, gde je i rodjen 1926 god, od oca Alije i majke Zade rodj.Velija, oženjen, otac 1 deteta, Šiptar, državljanin FNRJ, pismen- završio 2 razreda gimnazije vojsku služio 1944/48 god., vodi se u vojnoj evidenciji kod Vojnog otseka u Kos.Mitrovici, siromašnog imovnog stanja, nije odlikovan, neosud[illegible]n, u istražnom zatvoru od 16 aprila 1959 godine.

3. ŠERIFA MUSLIJU, zemljoradnika iz G.Prekaza, gde je i rodjen [illegible] god. od oca Muslije i majke Ajmone rodj. Bjošaj, oženjen, otac 2 de[illegible], Šiptar, državljanin FNRJ, pismen-završio 4 razred osnovne škole, vojsku služio 1954 god, vodi se u vojnoj evidenciji ko Vojnog otseka u Kos.Mitrovici, srednjeg imovnog stanja, nije odlikova neosudjivan, u istražnom zatvoru od 15 aprila 1959 godine.

4. BEĆIRA MEHAJA, zemljoradnika iz D.Prekaza, gde je i rodjen 1936 god. od oca Nebije i majke Anife rodj.Vojvoda, oženjen, otac 1 deteta, Šiptar, državljanin FNRJ, nepismen, vojsku nije služio privremeno nesposoban, vodi se u vojnoj evidenciji kod Vojnog otseka u Kos.Mitrovici, siromašnog imovnog stanja, nije odlikovan, neosudjiva u istražnom zatvoru od 15 aprila 1959 godine.

5. RAMADANA ZENELA, zemljoradnika iz G.Prekaza, gde je i rodjen 19[illegible] god. od oca Zenela i majke Zarife rodj.Bislimi, udovac, otac 2 dece, Šiptar, državljanin FNRJ, pismen-završio 4 razreda osnovne škole, vojsku služio 1937 godine vodi se u vojnoj evidenciji kod Vojnog otseka u Kos.Mitrovici, siromašnog imovnog stanja, nije odlikovan, neosudjivan, u istražnom zatvoru od 20 aprila 1959 godine.

6. ISTREFA OSMANI, zemljoradnika iz G.Prekaza, gde je i rodjen 1926 godine od oca Osmana i majke Raze rodj.Tahirović, oženjen, otac 3 dece, Šiptar, državljanin FNRJ, pismen-samouk, vojsku služio 1944/47 god. vodi se u vojnoj evidenciji kod Vojnog otseka u Kos. Mitrovici, siromašnog imovnog stanja, nije odlikovan, neosudjivan, u istražnom zatvoru od 20 aprila 1959 godine.

I TO

I

BISLIMA BISLIMA

Što je u toku 1958 godine na području Sreza Kos.Mitr vica stvorio ilegalnu-neprijateljsku organizaciju "Vujtet"- "Patnja", koja je imala za cilj da putem sile otcepi Autonor nu Oblast Kosova i Metohije iz sastava FNRJ, radi priključ Albaniji, pa je kao takav za rad u ovoj organizaciji prido

./.

Jovan Popoviqi, Prishtinë.

Ankesë kishin shkrua edhe avokatët e Bislim Bislimit dhe Adem Alies.

Të gjitha ankesat gjykata Supreme e Serbisë i kishte hedhur si të pabaza dhe i kthente edhe nji here për t'u vërtetua nga Gjykata e Qarkut ne Prishtine.

Pas verifikimit te dënimeve, te akuzuarit u dërguan për mbajtje dënimi ne burgje te ndryshme te Jugosllavisë...

~~~~~~

© Pashtriku.org, Qershor'2015

~~~~~~